




Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12.060-4544 dt. 24.01 2020

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr.03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Labinot Halilaj, më datë: 31/01/2020 (e premte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET

MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Betimi i asamblistit të ri Përparim Bajraktari nga Partia e subjektit politik- Vizioni për Drenasin, pas dorëheqjes së asamblistit Endrit Gllareva në Kuvendin Komunal Drenas.
2. Procesverbal i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.12.2019.
3. Draft Propozim strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal 2020 -2024.
4. Propozim Vendim për shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Drenasit për periudhën 2020-2028.
5. Plani vjetor i Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020
6. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2019:
 - a. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
 - b. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
 - c. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara.
7. Raporti Financiar i Zhvillimit të Buxhetit janar-dhjetor 2019.
8. Njoftim rreth përfundimit të kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
9. Të ndryshme.

Drenas, 24. 01 .2020



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060-4536 dt. 24.01.2020

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
27.12.2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 27.12.2019
Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 27 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 29.11.2019.
2. Prezantimi i anëtarëve nga Komisioni i Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore për konkurrentët e përzgjedhur në bazë të Konkursit dhe aprovimi i tyre.
3. Propozim Vendim për Aprovim: Plani Komunal për Zhvillimin Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor (PKZHIKPSH) Drenas-it 2020 – 2024.
4. Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2020-2024.
5. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2019.
6. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm Publik të pjesëve të ngastrave kadastrale, nëpër të cilat do të kalon rruga „Adem Jashari” e cila fillon nga Feronikeli nëpër Poklek, Korroticë e Ultë e deri në Korroticë të Epërme (te Kroni i Mbretit).
7. Aprovimi i Planit të Punës për vitin 2020, i Kuvendit Komunal.
8. Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën afatmesme 2020-2024.
9. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Drenasit për nevoja të komunitetit të fshatit Sankoc.
10. 10. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Drenasit për nevoja të komunitetit të fshatit Komoran.
11. Të ndryshme.



Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të dt. 27/12/2019 ishin 27 anëtar të Kuvendit Komunal si dhe Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i Komunës Nazmi Hasi, kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, përfaqësues të OSCE-së, përfaqësues të KDI-së si dhe Drejtor të Drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj- pasi pashëndeti të gjithë hapi seancën e rregullt të këtij takimi. Njëkohësisht njoftoj se teknika e transmetimit nuk bëhet direkt, dhe çështjen e votimit dhe prezencën kemi me e bërë me ngritje dore. Besoj se të gjithë jeni të njoftuar me rendin e ditës dhe jeni pajisur me material. Para se me shku me këtë rend dite a dikush diçka lidhur me rendin e ditës?

Drejtori për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të gjithë, para se me fillu me rendin e ditës i njoftoi anëtarët e kuvendit se kemi dy propozim vendime shtesë:

1. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Drenasit për nevoja të komunitetit të fshatit Sankoc, dhe 2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Drenasit për nevoja të komunitetit të fshatit Komoran. Mbledhjen e kaluar i kemi pas këto dy propozim vendime në Kuvend mirëpo MAPL-ja konfirmimin e saj e ka kthyer dhe këto dy vendime janë të paligjshme, kjo rrjedh sipas ndryshimit të ligjit për kategori, nuk parashihet brenda ligjit që të jepen në shfrytëzim prona për këto çështje, kështu që kisha kërkuar si komunë me respekt.

Kryesuesi Labinot Halilaj- a jeni për me e votu rendin e ditës me këto dy pika shtesë:

1. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Drenasit për nevoja të komunitetit të fshatit Sankoc, dhe 2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Drenasit për nevoja të komunitetit të fshatit Komoran. Prezent gjatë votimit ishin 23 anëtar, ju ftoj ta votoni: rendin e ditës se bashku me dy pika shtesë, rendi i ditës me këto dy propozim vendime shtesë u miratua në mënyrë anonime nga të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal me:

23 vota për

kundër 00

abstenim 00

Kryesuesi Labinot Halilaj -Hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Procesverbal i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 29. 11. 2019

Vehbi Berisha- është hera e parë që flas lidhur me procesverbalin, mirëpo konsideroj që të pika e dytë kur kam diskutuar unë, dhe kemi pasur një debat të gjatë, nuk janë përfshi fjalimet tona, prandaj ju thërras që të miratojmë më ndryshim që të shtohen gjitha fjalimet tona dhe diskutimet që janë zhvilluar atë ditë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- nëse e ke fjalën për pjesën në fillim ku është incizimi, tek pjesa e parë ka pas probleme teknike, arsyeja është ajo nuk i kemi futur në procesverbal, kemi pasur probleme me zërin e incizimit. E keni edhe incizimin ne youtube të cilin mund ta shikoni.

Petrit Gashi- atëherë nëse nuk i përfshini këtu fjalimet tona si i bien kjo, sa herë ne ia ndalim zërin dhe nuk përfshihet asnjë diskutim në procesverbal, por atë ditë ka qenë diskutim i gjatë dhe ju e dini shumë mirë çfarë diskutimi ka qenë, dhe shumica e diskutimeve këtu në kuvend nuk janë të përfshira hiq.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës me ndryshime, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar.

Për votuan 26 anëtar

Kundër 00.

Abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-Hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2.Prezantimi i anëtarëve nga Komisioni i Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore për konkurrentët e përzgjedhur në bazë të Konkursit dhe aprovimi i tyre.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj - Kërkoj një sqarim nga komisioni!

Fitore Morina: mënyra e zgjedhjes ka qenë korrekt, i kemi përzgjedh kandidatet që kanë qenë më të mirë të intervistë, dhe në kuadër të asaj u dashtë me qenë edhe barazia gjinore, u dashtë me i përzgjedh edhe dy meshkuj edhe ashtu nuk ka pas më shumë kandidat vetëm ata dy kanë qenë dhe vetëm ata dy i kemi përzgjedhur.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj - hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, anëtarët e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore të përzgjedhur në bazë të Konkursit janë:

Halide Morina
Besarta Demaku
Artan Hasani
Elira Tafilaj – Nebihi
Valmir Nishori

Ju ftoj me Votu këtë pikë të rendit të ditës me këtaanetar të Komitetit për Barazi Gjinore, të pranishëm ishin 26 anëtar:

Për votuan 26 anëtar

Kundër 00

Abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-Hapi diskutimin për piken e tretë të rendit të ditës: 3. **Propozim Vendim për Aprovim: Plani Komunal për Zhvillimin Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor (PKZHIKPSH) Drenas-it 2020 – 2024.**

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu: Sistemi i Kujdesit Parësor Shëndetësor në komunën e Drenasit zbatohet përmes funksionalizimit të konceptit të Mjekësisë Familjare, dhe paraqet shtyllën e sistemit shëndetësor të komunës me të cilën organizohet rrjeti i institucioneve shëndetësore (parësore) të shpërndara në territorin e komunës. Ky sistem, në Komunën e Drenasit sot përmbushë pothuaj 80% të shërbimeve shëndetësore për qytetarët. Kujdesi parësor shëndetësor ka rëndësi të madhe në shëndetin e popullatës dhe kërkon përkushtim nga politik bërësit dhe punëtorët shëndetësorë të Drenasit që të planifikojnë dhe punojnë drejt ndërtimit të një sistemi të ri dhe modern, të bazuar në konceptin e Mjekësisë Familjare, shëndet më i mirë për të gjithë, me shumë vite jetë, nëpërmjet shërbimeve shëndetësore cilësore të qëndrueshme dhe të përballueshme për të gjithë banorët e Komunës së Drenasit është qëllimi i përgjithshëm dhe vizioni që synohet të arrihet nëpërmjet Planit Komunal për Zhvillimin Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor (PKZHIKPSH), i cili paraqet një dokument të planifikimit afatgjatë dhe gjithëpërfshirës, dhe që pasqyron orientimin e Komunës së Drenasit drejt zhvillimit të kujdesit primar shëndetësor, duke synuar qëndrueshmërinë, koston efektive, mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës. Qasja e përdorur në hartimin e këtij Plani është e bazuar në metodën sasiore dhe cilësore të grumbullimit të të dhënave për nevojat shëndetësore të komunitetit nga dy perspektiva të ndryshme, përkatësisht të ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe atë të përfaqësuesve të komunitetit. Është përdorur parimi me qasje gjithëpërfshirëse dhe parimi i bazuar në evidencë duke përfshirë vlerësimin e nevojave shëndetësore të komunitetit. Nëpërmjet analizës së detajuar të situatës aktuale, Plani (PKZHIKPSH) pasqyron qartë gjendjen shëndetësore të popullatës së komunës së Drenasit, trendët s'mundshmërisë, lindshmërisë dhe vdekshmërisë, vizitat dhe shërbimet e ofruara në vitet e fundit në institucionet e KPSH-së, diagnozat që dominojnë në komunë etj. Është paraqitur organizimi i KPSH-së, zonimi i vendbanimeve, institucionet, burimet njerëzore aktuale në sistem, sistematizimi, financat, furnizimi me barëra esenciale, material shpenzues si dhe financime të shërbimeve shëndetësore.

Në bazë të tyre është bërë vlerësimi i nevojave të komunitetit, janë paraqitur problemet e identifikuar, është bërë prioritizimi i tyre dhe është bërë planifikimi 2 vjeçar i veprimit me 1(një) qëllim të përgjithshëm, 3 objektiva specifike, 15 rezultate dhe 101 aktivitete që kanë një kosto prej 4,035,492.00 eurove (duke përfshirë ndërtimin e objektit të ri të QKMF-se, me kosto prej 2,520,000 në të cilin komuna participin me 10%) për realizimin e këtij Plani. Është përpiluar edhe korniza e monitorimit dhe vlerësimit, në mënyrë që në çdo kohë të dihet niveli i zbatueshmërisë së tij. PKZHIKPSH do të ketë karakter dinamik, kostoeftektiv dhe i përshtatshëm periodikisht edhe me plotësim-ndryshimet e mundësime legjislativ nga ana e nivelit Qendrorë. Pas periudhës dyvjeçare ky Plan do të rishikohet, do të përfshijë ndryshimet potenciale të legjislaturës dhe do të përpilohet plani i veprimit për periudhën e mbetur. Bazuar në gjendjen dhe kapacitetet aktuale, misioni, vizioni, objektivat dhe aktivitetet e këtij Plani janë hartuar në përputhje me ligjet, udhëzimet administrative, me strategjinë sektoriale shëndetësore dhe dokumentet tjera relevante ekzistuese në legjislationin e Republikës së Kosovës.

E falënderoj Këshillin Drejtues për hartimin e planit komunal insutucional të kujdesit parësor shëndetësor, për një punë të vazhdueshme dhe shumë të përkushtuar pothuajse 9 mujore që arritëm brenda vitit 2019, të finalizojmë një dokument strategjik si ky. Ju ftoj ta votoni këtë plan komunal.

Vehbi Berisha- e përgëzoj komisionin për hartimin e një dokumenti të tillë strategjik, mirëpo si çdo dokument, natyrisht se ka edhe të dhëna, sugjerime dhe rekomandime nga ana jonë, që unë mendoj se do të ishte mirë të shtjelloheshin me në detaje gjithsesi për të vetmin qëllim në të mirën e qytetareve. Më gëzoj fakti se këtu tek plani i veprimit është paraparë një buxhet bukur i madh prej 4 milion e 35 mijë euro të cilat parashihen të investohen për vitet e parapara sipas planit, po ashtu më gëzoj fakti që në tre mujorin e 4 të vitit 2020 parashihet rregullimi i ashensorit në QKMF i cili ka qenë premtim i kryetarit aktual. Tash kur ta shikosh një ashensor që u dashtë vite për me u rregullu, dhe kur t'i shifsh tani këto shifra milionëshe të cilat presin me u implementu të lindësh për me shpresu për një të ardhme ma të mirë që këto çka kanë shkruar për me u implementu deri në përpikëri apo 100%, çështja tjetër që dua ta ngiti këtu para jush është se ne me të vërtetë nuk jemi duke vuajtur nga mungesa e infrastrukturës, ne po vuajmë nga mungesa e kuadrit profesional, po vuajmë nga mungesa e pajisjeve adekuate të cilat e lehtësojnë shërbimin shëndetësor për qytetarë në Drenas. I pash mijëra euro të dedikuara për ndërtimin e objektivave të reja të QMF-je në fshatra dhe pyes: nëse një pacient shkon në një fshat, ai duhet me marrë një shërbim aty dhe prapë duhet me dalë me i ble barnat në Drenas, dhe shumica prej tyre e injorojnë shërbimin aty, jo pse nuk ka mjek adekuat, po është puna se ai person prapë duhet me dalë në Drenas me i ble barnat, nëse mendohet në detaje aa ia vlen me u dhënë një shumë e caktuar e mjeteve për me u ndërtu një qendër e mjekësisë familjare dhe në fund me u përdor shumë pak, qëllimi jonë që e ngritëm këtë çështje është të ofrohen shërbime dhe të ofrohet resurset edhe njerëzore aty ku ka më së shumti nevojë, unë nuk e pash askund idenë e themelimit të një shërbimi emergjent i cili ka me u marrë vetëm me terrenin, mua më ka ndodhë disa raste por besoj që edhe kolegeve të mi, kur shpesh kur kemi aksidente, doktori duhet më i lënë

pacientët aty duke prit për me shku në aksident, kishte qenë me mirë me themelu një qendër të posaçme e cila ka me u merr më raste emergjente të ternit e jo me i dhënë 150 mijë euro në një fshat ku prapë qytetari duhet me dal në Drenas, dhe nuk shkon hiq për arsye se prapë duhet me dal në Drenas, ne po kemi problem edhe me resurset shëndetësore këtë aspekt, dhe ideja e gjithë kësaj është që të lehtësohet sidomos aty ku është vështirësia më e madhe.

Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- shërbimet në shëndetësi janë përmirësuar dukshëm shumë, QMF-në në Komoran po e lëshojmë një vjet para kohe, e kemi lëshuar shërbimin 24 orë me herët, por tani objektin e ri po e inaugurojmë një vit para kohë, sipas projektit është e paraparë me përfundua në fund të vitin 2020, por ne këtë vit po e përfundojmë dhe këtë vit po e hapim. Shërbimet nëpër fshatra janë të parapane barnat ose shërbimet bazike të cilat i merr qytetari, ndërsa barnatoret nuk mundemi me i qu ne çdo fshat askujt. Unë kërkoj nga ju që të na jepni ju rekomandime të mira që ne shërbimet ndaj qytetareve t'i bëjmë më të mira.

Petrit Gashi, sa i përket këtij drafti edhe pse shumica është vetëm përshkrim dhe ne duhet me u ndal në gjendjen faktike e cila u bë dy vitet e kaluara, unë po flas vetëm për qendrën e mjekësisë familjare në Arllat vetëm një staz nuk është bërë për invalid për dy vite, dhe nëse e merr pacientin dhe ki invalid dhe e dërgon në Arllat, më mirë duhet me ardh në Drenas për shkak së duhet duhet me i marr edhe disa ndihmës dhe me e fut brenda pacientin sepse nuk ka mundësi me hy brenda, ndërsa qendra e infuzioneve nuk punon për tri vite me radhë një dhomë për infuzione për pacient nuk është bërë, dhe në Komoran dhoma për infuzion nuk është si duhet sepse shpesh ndodh që pacientet duhet me marr infuzione ne karrige.

Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- ne kemi shumë objekte këtu që jemi detyruar me ia ndal punën sikur ndërtimet në Terstenik dhe shumë vende tjera që jemi detyruar me ia ndal punën sepse projektuesit i kanë bërë projektet pa e paraparë kanalizimin u ujërave të zeza në objekt, pa e paraparë ujësjellësin në objekt pa i paraparë shumë punë në objekt. Sa i përket dhomës për infuzion ndodh nga një herë që me marr edhe infuzionin edhe në karrige për shkak se ka pacientë shumë dhe nuk ka vende të lira dhe ndoshta u dashtë që shërbimin me e kry në ndonjë formë, doktori të pacienti, ne doktorin tek pacienti e dërgojmë por doktori shkon tek pacientët kur pacienti nuk munden me shku të mjeku, për personat që nuk munden me shku të mjeku për personat të moshuar, sa i përket numrit të mjekëve i kufizuar ne kemi mungesë të buxhetit edhe për shërbimin që e bëjmë 24 orë në Komoran kemi pas probleme me pagesën e mjekëve që e kryen shërbimin 24 orë në Komoran, në Komunën e Drenasit janë tre teknik për një doktor, ndërsa duhet me qenë 1.5 për një doktor, kemi dy fish të numrit të punëtorëve teknik, këto janë probleme të krijuara që nga pas lufta të cilat nuk mund të zgjidhen shpejt as për një vjet as për dy e tri as për pesë vjet.

Petrit Gashi- unë po flas për pacient që nuk kanë mundur me shku të mjeku sepse kanë qenë pacient që kanë qenë invalid dhe pacient te tjerë që kanë pas të meta psiko-fizike dhe doktori nuk ka pas mundësi ime ardh, jo që nuk ka dashtë po nuk ka pas mundësi me ardhë. Kërkesa për staz u bë në shkurt të vitit 2018 për fshatin Arllat, nuk ka qenë problemi që nuk kanë qenë të informuar për atë problem atje por prapë nuk e keni përfshi në këtë draft që do të behët. Ne kërkojmë se gjendja më e vështirë dhe njerëzit që kanë më së shumti nevojë janë ata që të kërkojnë trajtim mjekësor dhe për këtë arsye të paktën atyre të ja japim mundësin të ju ofrohen ato shërbime që kërkohen, dhe të numri i punëtorëve nëse nuk kemi punëtor të mjaftueshëm,

mund ta rregulloni orarin, i keni tre punëtor teknik paradite ndërsa pasdite është mbyll, mundeni me gjet njëfarë mënyre që me e rregullu të paktën orarin.

Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovi – Nuk kemi të bëjmë me punëtor teknik por kemi të bëjmë me mjek sepse punëtor teknik kemi mjaftueshëm, i kemi tre teknik për një mjek, duhet me qenë 1.5 për një mjek, është rregull, dhe kemi përgjysmë më shumë punëtor teknik.

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu- Plan i besoj që është një ndër planet më të mira, dhe këtë plan ja dedikoj dhe e përgëzoj komisionin për punën e palodhshme që e kanë bërë me kohëzgjatje nëntë mujore. Problemet që i ka shëndetësia i keni në faqe 39, ku nuk janë një ose dy probleme siç ke ajo barriera që u përmend, por janë të identifikuara pothuajse të gjitha problemet, janë afër 47 probleme të cilat janë identifikuar në të cilat janë vlersu për nga kriteret siç është lehtësia në zbatim për nga kostoja e saj, a do të jetë mundësia korniza kohore, përfitimi i pacientëve nga kjo siguri dhe në bazë të pikëve të cilat janë vlerësuese e cila ka prioritet. Problemi i shtrirjes dhe kujdesit parësor shëndetësor përmes mjekësisë familjare, sipas projektit është që të standardizohen shërbimet shëndetësore në të gjitha qendrat të mjekësisë familjare që përfshihen të njëjtat sikur në Drenas. Qëllimi i planit është që të bëjmë risistemimin e punëtoreve në raport me numrin e banorëve dhe të largohen ai grumbullim i tepërt për arsye që instalimi dhe fillimi i punës me sistemin e digjitalizimit të punës ka bërë patjetër të mundur që sigurimet shëndetësore do të jenë jashtëzakonisht precize ku çdo ordinancë do të ketë emrin mbiemrin kush punon dhe kohën në sa, ky plan ka për qëllim që të stabilizohen numri, resurset humane, pjesa e teknologjisë, qasja në teknologji dhe nivelizimi i standardizimit i shërbimeve shëndetësore në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare. Ndërsa ambulancat familjare do të këtë edhe një vlerësim kosto efektiv për arsye se disa vlejné të investohen diku ndoshta nuk vlen të investohet, kështu që kjo krejt mbetet një çështje e ndryshueshme për përdhën 4 vjeçare.

Vehbi Berisha- sigurimi shëndetësor nuk është në përgjithësi e komunës, ti e ceke që duhet me ia siguruar emergjencat për banoret lokal, Komuna Drenasit ka shtrirje gjeografike midis akseve rrugore që janë më të frekuentuara, ndoshta nga Skenderaj vjen dhe bënë këtu aksident dhe nuk e thirr ambulancën e Skenderajt por të Drenasit, Prishtina e ka shërbimin emergjent, kur mundemi me ndërtuar një ambulancë që kushton 150 mijë euro mundemi me ndërtuar edhe ambulancë emergjente.

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu- atë kompetencë e ka vetme niveli qendror ne e kemi vetëm shërbim emergjent 24 orë në Drenas, kjo është kompetenca ligjore e komunave, në qoftë se na vjen ajo çështje duhet t'i kemi vendet e punës, detyrat e punës dhe dhomat të cilat duhet t'i këtë një punëtorë shëndetësor. Qëllimi i këtij plani është që ne të jemi të përgatitur për periudhën e ardhshme dy vjeçare eventualisht me ndryshime legjislacioni.

Petr Gashi- Faktikisht drejtor, askush nuk e kontestoi planin, ne thamë se është i mirë sa është implementueshëm, prej 06.02.2019 shtatë herë është prishur laborator i analizave në Drenas, ne nuk kemi arritur të bëjmë një laborator të analizave që bënë të gjitha analizat në Drenas, ne po e dimë që për katër vite i kemi krejt këto shifra milionëshe të cilat ne dojmë me i ralizuar shumë mirë nëse realizohet, nëse realizohet duhet me ju përgëzua po unë jam i bindur që nuk realizohet për tri vite s'keni arrit me realizuar një laborator të analizave Drenas, e po arritni me i ralizuar

shumë gjëra tjera, këtu qëndron problemi, nëse është i implementueshëm sa kemi kapacitete na me implementu këtë plan që e kemi shkru.

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu- Këtë vit laboratorin e kemi të kompletuar në Drenas dhe bëhen të gjitha parametrat e standartizime sipas udhëzimit administrativ, mund të ketë periudha të furnizimeve jo të kënaqshme me materiale. Menjëherë vitin e ardhshëm pas ridestimeve do të fuqizohet laboratori i dytë në Komoran do të vazhdohet me punën në QMF në Arllat, që do të thotë janë shërbime të përcaktuara, për këto shërbime kemi pasur buxhet, ka edhe sot, janë aparaturat të cilat i kemi marrë nga Ministria e Shëndetësisë, komplet më bashkëkohore që ekzistojnë deri sot, dhe standardizimi që përmenda përveç shërbimeve shëndetësore këtu e nënkuptova edhe laboratorët nëpër qendra të mjekësisë familjare mendojmë që në një periudhë të ardhshme për katër vite të jenë të njëjta si në Drenas si në Arllat si në Komoran apo fshatrat tjera, kjo është ajo që ne mundohemi këtë fluks të tepërt të 80% të kryhen në Drenas vetëm në qendër.

Haka Tahiri- Gjatë diskutimit që bëri drejtori për me qenë një mjek në një shtëpi të shëndetit në një punë duhet me qenë numri i banorëve, a mundem me dit sa mundet me qenë numri i banorëve për të pasur drejt me qenë një mjek ? Tani u cek se kemi punëtor teknik numër të mjaftueshëm, derisa ka numër të mjaftueshëm të teknikëve pse në Terrdecit nuk ekziston tekniku tani është vetëm një herë në javë edhe mjeku edhe tekniku. E kemi shkollën afer po kemi probleme për çdo ditë, nëse ka numër të mjaftueshëm të punëtorëve teknik, se paku me qendru tekniku se paku çdo ditë siç ka qendru deri tash, mjeku një herë në javë është e mjaftueshme, por tekniku kemi nevojë me qenë çdo ditë me qenë aty.

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu- Kriteri është sipas MAPFSH-së një mjek në 2 mijë banor 2 infermier për një mjek, kjo është ekipi i mjekësisë familjare, ju fshati i Terrdecit, Baicë, Abri do të hyni në qendrën e mjekësisë familjare të Baicës ku do të keni mundësi me zgjedh mjekun familjar.

Sokol Bylykbashi – të nderuar, këto dokumente janë të rëndësishme dhe unë personalisht e votoj edhe ka vetëm një ide se si të përmirësohet gjendja në një fushë të caktuar shoqërore, vetëm një ide me pas unë e votoj, sigurisht që e kritikoj për mangësi, por me votu e votoj, edhe ky plani për shëndetësi ka atë pjesën në fund me disa hapa që duhet me ndërmarr për me ndryshuar gjendjen, të këto plane ka diçka të mirë që në një far mënyre nuk i konvenon edhe shumë e atyre që i udhëheqin pra kryetarit edhe këtyre tjerëve, në këto plane nuk mundesh me ju ik pa i përmend mangësitë mirëpo në njëfarë mënyre e pranon, sa ma shumë që ju ik problemeve aq më i dobët del plani. Këto plane tregojnë gjendjen reale në fushë të caktuar, në këtë rast në shëndetësi, shihet sa problemet i kemi, probleme edhe bazike, kosto të ulët, probleme që është dashtë me zgjedh jo vetëm tri vite tash që i ka kryetari Lladrovci duke udhëhequr por edhe më herët, por nuk janë zgjedhë. Puna e liftit, dmth janë 3 vjet që një lift nuk është rregullu, ka diçka edhe më të vogël që kushton edhe shumë ma lirë dhe nuk është rregullu, nuk po thamë që nuk ka vullnet por

drejtorët duhet me qenë pak ambicioz me shiku problemin dhe me ndryshu at problem, besoni me pak pare bëhen shumë ndryshime, kryetari përmendi disa shifra për ndryshime, nuk është mirë na me fol me këto shifra e sidomos me pare që nuk janë të komunës, nuk e di sa kohë merr me u ndertu ai objekt, mirëpo nuk është mirë me qëndru një objekt kryesor i mjekësisë familjare me qëndru pa lift ose pa gjëra bazike, tu përfshi edhe aparatura edhe materialet shpenzuese. Është shumë me rëndësi zbatueshmëria, fokusi me qenë të zbatueshmëria e këtij plani për këtë arsye po e miratojmë, nëse nuk ka zbatueshmëri atëherë e miratojmë qashtu se plani shumë i mirë, ka ide shumë të mira që është dashtë me u kry shumë ma herët, ka mujt me u kry edhe ma herët edhe gjatë qeverisjes tuaj këto tri vite, por ideja është të zbatueshmëria, prandaj ne e lidhum me premtimet, ka edhe plane tjera strategjike i keni përmend disa veprime qe keni premtu me u realizu shumë ma herët, unë qysh e kam pa në fusha tjera është kjo dmth deri në vitin 2022 nuk parashihet me ndërmarr diçka, a premtimi ka qenë brenda mandatit 4 vjeçar , nuk është koha me t'i përmend premtimet sepse i ke edhe dy vjet. Për fund është një plan që ia vlen me u votu dhe shpresoj që zbatohet, unë të gjitha dokumentet sidomos planet i sistemoj, por këto plane qe i kemi sot ne rend dite kam me i theksuar pak për dy arsye, e para më duhen mu kohë pas kohe janë disa të dhëna si skanim i gjendjes qe është bërë në teren dhe e dyta po dua me i shiku zbatueshmërinë e këtyre planeve e këtë e shohim më së miri kur vijmë draft buxheti.

Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- Sokol nuk jam kundër me kritiku dhe me debat, por thash a e votojmë planin i cili është një plan strategjik për vitin 2020-2024 . Planet strategjike që sot i kemi para vete të diskutojmë për to, si të bëjmë shërbimin më të mirë ndaj qytetarit 2020-2024 dhe t'i marrum ato ndryshime që mendoni ju të inkopurojm në këtë plan nëse ka hala edhe diçka me inkopuru edhe të e realizojmë. Unë për QKMF-në e kam bërë projekt, dhe këtë projekt timin e kanë marrë edhe tri-katër komuna tjera të cilat ka vendosur niveli qendror ka bërë memorandum për me e ndërtuar objektet e reja, ndoshta nuk na ndërtojnë por paret e nivelit qendror në qoftë se ne arrijmë me i orjentu në Drenas është merit e jona nuk është merit e dikujt tjetër sepse ne i kemi edhe 9 milion euro, të cilat nuk kemi mundur me i zhvillu në rrugën katër korsi në Komoran-Drenas, por ai që se ka zhvillu këtë projekt është në përgjegjësi.

Sokol Bylykbashi- Unë e kam lexu para një viti apo dy nuk e di sigurt, ligjin për shëndetësinë edhe qe ka të bëjë kompetencat e institucioneve shëndetësore në nivelin lokal edhe masat e shërbimit që i ofrojnë nivelit lokal, prej një seri shërbimesh që ju ofrohen përmendet edhe një shërbim, intervenimet e vogla kirurgjikale ose prerje ose çkado , a kryhen këto intervenime në qendrën tonë kryesore familjare?

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu- Ne po flasim për një projekt për një plan që të përmisojmë këto qe i gjeni në faqe 39 i keni të indentifikuara të gjitha problemet e mundshme të cilat mund të zgjidhen menjëherë pa kosto, dhe të cilat duhet të zgjidhen me një kosto që është papaparë.

Arta Xhylani- pyeti: pasi që si grup keni punuar me grupe fokuse vetëm desha sqarim lidhur me planifikimin e sistemit të mjekësisë familjare për pesë vite që është bërë për doktor dhe infermier, ju e ceket që i keni ndarë në bazë të numrit të banorëve apo si është bërë planifikimi për shkak që sepse po e shikoj se Drenasi prej Komorani i kanë dallim përafërsisht 400 banor dhe kanë bërë ndarjen e doktorëve dy doktor, ndërsa në mes Terstenikut dhe Gllanaselles që i kanë më shumë se 1000 është numri i njëjtë i doktorëve dhe infermiereve nga 3, i keni të cekura tek faqe 28 të planifikimi i sistemit të mjekësisë familjare për pesë vitet e ardhshme, e keni bërë ndarjen në Terstenik dhe Gllanasellë numrin e njëjtë të doktorëve, ndërsa dallimin në banorë nëse e keni bërë dallimin e planifikimit në bazë të numrit të banoreve siç e ceket me herët, ndërsa dallimi në Komoran dhe Drenas janë vetëm 400 banor, ose Arllati me Gllanasellë dua ta dijtë si e keni bërë ndarjen e infermiereve dhe doktorëve.

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu- për në Komoran e keni tabelën fq. 28 e keni sqarimin.

Beqir Kiqina- sa i përket një çështje që e ngriti kolegu Sokol Bylykbashi që e ceku se a behën ndërhyrje të vogla kirurgjikale në QKMF, këto shërbime nuk kryhen, kirurgjikale të vogla, këtu ne kemi familjar që i frekuentojmë këto qendra dhe për një rast më të voglin jemi të detyruar më shku në Prishtinë dhe me i kry ato nevoja të cilat na duhen, nuk janë as mjetet më elementare rezerva sa i përket këtyre çështjeve.

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu, rreth çështjeve të shërbimeve të vogla kirurgjike ato kryhen në QKMF, fq 29 e keni edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike, janë në kompetencën e specialistit familjar, nuk janë kompetencë e çdo mjeku, i vetmi personel i cili nuk është i mbrojtur me ligj është personeli shëndetësor, ne nuk e kemi numrin e mjaftuar të mjekeve specialistë familjar. Ato shërbime kryhen nga mjeket që kanë kompetencë me kry atë punë, dhe ka mjete adekuate për këtë çështje.

Petrit Sinani- secili prej neve është i shqetësuar me gjendjen e shëndetësisë dhe secili prej nesh kërkon që gjendja e shëndetësisë me u përmirësu, dhe ky është një plan është i detajuar i cili na tregon me shifra të detajuara se ku kemi ngec dhe ku kemi mundësi me u përmirësu, ajo çfarë është më rëndësi për mendimin tim me u cek, me sa po shoh numri i lindjeve të regjistruara gjatë tri viteve të fundit kemi një ulje të lindjeve domethënë në krahasim me vitin 2018 kemi diku deri 33 lindje me pak se sa ne vitin 2016 dhe normalisht kemi trend të rritjes se vdekshmërisë të pacienteve, po e krahasoj në bazë të kësaj se çka po shoh se janë një varg të faktorëve që ndikon në parandalimin e këtyre sëmundjeve. Unë mendoj që askush nuk është mirë me paragjyku punën e mjekeve sepse mjeket janë duke e bërë maksimumin sepse sa herë që shkojmë na i gjejmë me shumë pacientë, por na jemi këtu për ta përmirësuar këtë gjendje, kisha pas dëshirë që në këtë plan me u inkorporu edhe format se si ministria e ka mendu që qoftë sëmundjet qoftë simptomat tjera me u inkorporu në këtë, dmth cilat janë mënyrat që ne mundemi për me arrit deri te parandalimi i këtyre gjërave, sa i përket maternitetit e pash nuk jam shumë ekspert i fushës se mjekësisë mirëpo e pash se nuk është planifikuar as edhe një doktor ne maternitet, desha me dit cila është arsyeja, kishte qenë mirë që në maternitet më qenë një doktor sepse po e shoh që

ne disa vende ishin pesë fish teknik me shumë, jo vetëm tre fish në disa QMF-ja, Drenasi me herët është njohur për një gjinekologji shumë te zhvillume kisha pas dëshirë që këtij reparti ti jepet një shtytje me e madhe edhe normalisht që me u inkorporu në këtë plan për ma tepër po besoj që ajo çfarë nuk është vërejtur me sa pash që këto të dhëna janë nxjerrë edhe prej sistemit informativ shëndetësor gjinekologjik.

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu- i keni të gjitha të cekura në plan, por ne deri më tani e kemi pas vetëm një gjinekolog, ka ardh gjinekologu i dyte i cili e ka përfunduar specializimin dhe presim gjinekologun e tretë. Në përgjithësi trendët e lindshmërisë kanë ardh duke u zvogelu.

Kryesuesi Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës : Prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar,

Për votuan 26

Kundër 00

Abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj- Hapi diskutimin për piken e katër të rendit të ditës: 4. **Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2020-2024.**

Drejtoreshë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu- nder objektivat e drejtorisë për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit gjatë vitit 2019 ka qenë edhe hartimi i planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit, në bazë të kësaj për hartimi ne planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit kryetari I komunës ka marrë vendim për themelimin e ekipit komunal për hartimin e planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit për periudhen e zbatimit 2020-2024. Komuna e Drenasit ka hartuar planin lokal të veprimit për cilësi të ajrit i cili është një dokument planifikues strategjik për të adresuar zgjidhjen e cilësisë së ajrit në nivel lokal për periudhen zbatuese 5 vjeçare 2020-2024. Qëllimi i planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit është ti definoj veprimet për menaxhimin e cilësisë së ajrit brenda territorit të Komunës së Drenasit për periudhë 5 vjeçare. Objektivat specifike të planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit janë : Analiza e gjendjes ekzistuese dhe burimeve kryesore të ndotjes së ajrit, identifikimin e problemeve kryesore për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe planifikimin e afateve, veprimeve, aktiviteteve dhe projekteve kryesore që do të ndërmerren për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Hartimi dhe miratimi i këtij plani është i një rëndësie të veçantë për komunën dhe është kërkesë ligjore që del nga ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe po ashtu është pjesë e angazhimeve të komunës për përmbushjen e përgjegjësiave për fuqizimin e qeveris lokale. Planit lokal i veprimit për cilësi të ajrit është në harmoni të plotë për planin lokal të veprimit në mjedis me planin zhvillimor komunal dhe me dokumente tjera strategjike. Duhet cekur se ky plan është hartuar para se të bëhen matjet e fundit në të cilën matjet nuk kanë dal në bazë të parametrave me një ajër të ndotur, andaj unë ju ftoj, që ta nisim këtë procedurë, ta miratojmë këtë plan dhe ta zbatojmë në mënyrë që niveli i ndotjes së ajrit për komunën e Drenasit të jetë në harmoni të plotë. Duhet theksuar se këtë plan komuna e Drenasit më herët nuk e ka pasur, është komuna e vetme në nivel qendror pas komunës së Gjakovës me këtë plan, andaj ju ftoj ta miratoni.

Petrit Gashi- Desha me pyet për anëtarët e komisionit, cili është ekspert se shumicën prej tyre nuk i njoh me na tregu sa ka mundur me kontribu, dhe me na indentifiku faktorët kryesor për

ndotjen e ajrit në Komunën e Drenasit sepse nuk e pashë se faktori kryesor numër një ndotësi që akuzohet prej të gjithë mekanizmave tjerë të cilët përcjellin cilësinë e ajrit në Drenas është përmend shumë herë, pra e para : Anëtarët e komisionit sa janë ekspert prej tyre në këtë fushë dhe kush është ekspert që ne me e ditë të paktën ku mu drejtu.

Drejtoreshë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu - Ky vendim është formuar si ekip komunal që ka qenë brenda stafit profesional të komunës. Si anëtar profesionist në këtë fushë e kemi Haki Bekolli i cili ka qenë edhe shef i mbrojtjes së mjedisit të planifikimit urban, po ashtu kemi Adhurim Hoxha i cili e njeh fushën, është në kuadër fushës së ekologjisë mbrojtjes së mjedisit, po ashtu kemi edhe nga shoqëria civile Arben Nika i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, mirëpo pavarësisht kësaj e kemi pasur edhe kompaninë që është kryesisht për mjedisin që i ka kordinu këto të dhëna që i ka ofru grupi punues. Ndërsa sa i përket pyetjes së cilët janë ndotësit në Komunën e Drenasit, shfleto planin në faqen 21 jan të cekur ndotësit kryesor në Komunën e Drenasit që mund të konsiderohen aktivitetet nga operatori industrial nga Feronikeli, transporti rrugor , përdorimi i thëngjillit, drurit ekonomit familjare komerciale , institucionale si dhe aktivitetet e gurthyesve.

Petrit Gashi- Mos harroni se Komuna e Drenasit për tri ditë ka qenë komuna më e ndotur në Kosovë. Ashtu si kam menduar ashtu edhe po e shoh, prej 13 anëtarëve të ekspertëve vetëm 3 anëtar po dalin me qenë gjysmë ekspert, pra na si mundemi me ndërtu një plan në këtë fushë kur kemi mungesë të ekspertëve, dmth me këta njerëz të cilët e kanë përpiluar këtë plan nuk janë ekspert të këtyre fushave, qysh mundemi me prit rezultate prej këtij plani kur prej 13 anëtarëve vetëm një është ekspert.

Drejtoreshë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu - Petrit nuk mundesh me than që nuk ka pasur ekspert për arsye se kompania në faqe 9 e ki është cekur që është hartu kompania pikërisht për këtë punë për të hartuar planin që është fushë e ekspertëve të mjedisit që kanë hartuar planin dhe kanë identifikuar kryesisht masat.

Vehbi Berisha- Tek planet e mëhershme komisioni, është e vërtet që është propozu prej kryetarit të komunës, por është miratu në kuvend. Në këtë rast me çfarë të drejte me çfarë baze ligjore e merr vendim kryetari, përderisa ky dokument duhet të miratohet prapë në kuvend, dhe një dokument që miratohet në kuvend duhet gjithsesi komisioni me atë komision që me mandatu kuvendi, kjo është ajo arsyeja që më është duk shumë jo ligjore.

Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- I kemi respektuar të gjitha procedurat ligjore.

Drejtoreshë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu -Ligji për vetëqeverisje lokale përcakton që kryetari nxjerr vendime brenda kompetencave të veta, ndaj ky rast është vendimi për themelimin e ekipit komunal, dmth ekip komunal nënkupton stafin që janë brenda në kuadër të komunës dhe është zyrtar kryesor administrativ në këtë aspekt, ka qenë edhe planifikim buxhetor investim kapital.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- Ky plan është I hapur për ndryshime, e rëndësishme është se ne e kemi një plan, ma mirë është një plan se mos me pas planë hiq, ma e mira është se jemi ndër komunat e para që e kemi bërë këtë plan andaj un ju ftoj ta propozoni këtë planë.

Kryesuesii Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës :
Prezent gjatë votimit ishin 25 anetar,

Për votuan 22

Kundër 00

Abstenim 03.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- Hapi diskutimin për piken e pestë të rendit të ditës: **5. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoba 2019.**

Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik - Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba 2019, ky ndryshim është kërkuar me kërkesë të drejtorisë të zhvillimit ekonomik dhe unë si drejtoresh mundohem të mbroj punën vetëm sa i përket ndryshimeve në kuadër të zhvillimit ekonomik. Unë kisha qenë e pajtimit që prezent në këtë komision të jenë edhe asambleistat por edhe ekzekutivi nga pjesa tjetër që komisioni të mbroj punën të cilën e ka bërë në ndryshimin e kësaj rregulloreje.

Petrit Sinani- të nderuar ne si komision në përbërje prej tre asamblistëve unë Petrit Sinani, Burim Bujupit, Hamit Kastratit dhe tre punonjësve komunal: Shehrijë Mustafa, Ruzhdi Lestrani dhe Hamdi Krasniqi jemi munduar që të bëjme hartimin e rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoba dhe normalisht kemi sjellë edhe Draft propozimin për këtë rregullore për ndryshim plotësim, para se me shku të secilit kategori veç e veç do të doja të them që po thuajse 100 % të taksave kemi bërë aty të kategoritë e nevojshme kemi bërë ulje të taksave përpos nëse janë përcaktuar ndryshe me udhëzim administrativ duke pas edhe përkrahjen e konsultimit të nevojshëm edhe me kryetarin e komunës dhe qytetaret, para se me i lexu veq e veq ne kemi mbajtur edhe takim publik me qytetaret ku i kemi ftuar personat e involvuar në këtë rregullore, ku i kemi ftuar biznese të ndryshme të jenë prezent dhe të japin edhe sugjerimet dhe mendimet e tyre në lidhje me këtë rregullore, kjo rregullore afekton pothuajse gjithsecilin prej neve dhe normalisht është shumë e rëndësishme për komunën tonë, rregullorja në përgjithësi ka qenë e punuar mirë por kemi bërë disa shtesa në rregullore, fillimisht tek neni-12 kemi thënë që drejtoritë të mos jenë emplementues por të jenë përgjegjës e kemi zëvendësuar fjalën emplementues me fjalën përgjegjës na u ka dukur më e arsyeshme që këto drejtori të marrin përgjithësi, nga shërbimi i archives janë pothuajse të gjitha të njëjta mirëpo kemi bërë edhe një ndryshim psh. dhënia në shfrytëzim e projektit dokumentin i cili gjendet në kuadër të dokumentacionit teknik për një ditë për persona privat, tek neni-13 po fillojmë me drejtorinë për zhvillim ekonomik ndryshimet që i kemi bërë, psh të metalurgjia e rende shkretoret ka qenë 70

mijë e kemi bërë 65 mijë si propozim i komisionit, këto janë normalisht propozimet tona pastaj asambleja vendos me votu apo mos me votu, tek minierat i kemi bërë 25 mijë euro nga 30 mijë sa ka qenë, posta dhe shërbimet postare e cila ka qenë 1000 e kemi bërë si propozim për 900, për bankat ka mbetur e njëjtë, institucionet mikrofinanciare nuk janë shtuar në këtë rregullore me siguri është gabim teknik e kanë harruar ka qenë 1000 mbetet prap 1000, pompat e derivateve në rrugën magjistrale ka qenë 3000 mijë është bërë 2000, bastoret që ka qenë për shkak të ligjit nuk janë përfshi në këtë rregullore janë hiq komplet prej rregullores, pompat e derivateve në rrugë regjionale ka qenë 1500 është propozim 800, pompat e derivateve në rrugën lokale ka qenë 300 propozimi është 200 këto janë vetëm ndryshimet që ne i kemi propozu. Te veprimtarit tjera janë ordinancat shëndetësore që ka qenë 600 kemi propozu 380, ordinanca stomatologji ka qenë 600 kemi propozu 360, barnatoret 500 i kemi propozu 250, përmbaruesit privat i kemi propozu që të rritet nga 1000 të bëhet 700, te avokaturat 500 të bëhet 200, te noteri 700 kemi propozu të bëhet 500, agjensit e ndërmjetsimit dhe transaksionit pasuri të patundëshme ka qenë 500 kemi propozu 400, të veprimtarit e shtypshkronjave dhe aktiviteteve grafike ka qenë 200 kemi propozu vetëm 70, të tregtia, ka qenë tregtia e automjeteve të reja ma herët dmth ka qenë më e lartë se tregtia e automjeteve të vjetra dmth. e kemi ndryshu e kemi rritur, tregtia e automjeteve të vjetra e kemi bërë 500 ka qenë 300, tregtia e automjeteve të reja e kemi lënë njëjtë, ndryshime totale kemi bërë mas neni 13.5 dilni në faqen tjetër, ku kemi thënë gjdo biznes vitin e par të themelimit edhe regjistrimit pa marr parasysh datën e regjistrimit të lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste, më herët ka qenë e përcaktuar me vite kurse tash e kemi lënë në atë vit që regjistrohet sepse ti nuk mundesh meja përcaktu vitin psh. aj mundet me qenë viti 2020-2025 atëherë çdo biznes në vitin e parë të themelimit, dmth kur e ka vitin e parë të themelimit, të gjitha BIT,NTB, NSH, NH si dhe ato përpunuese si dhe të gjitha llojet e ndërmarrjes me pakicë janë të liruara nga viti 2018 deri në kohën e përcaktuar me rregulloren e kalume. Sa i përket pasqyrave financiare në ATK ne e dimë që pasqyrat financiare bëhen deri më 31 mars dhe dorëzohen në ATK me 31 mars, kemi kërkuar që periudha e raportimit të jetë me formular 0 sepse janë të liruara prej taksës dhe kemi kërkuar të na sjellin të vulosura prej ATK-së, kur e vendosim takson e një biznesi atëherë e marrim për bazë veprimtarinë e tij dhe qarkullimin psh kur ka qenë me qarkullim i vendoset taksa për veprimtarinë e jo në bazë të qarkullimit. Të parkingjet të neni 14.15 të cilat janë të rezervuara për hapësira publike për një vit në zonën e parë ka qenë 120 ne kemi propozu me u ul me u bë 100. Sa i përket tarifave kadastrale ato janë të përcaktuara me udhëzim administrativ andaj ne nuk kemi mundur me ndërhy dhe nuk mundemi me përcaktu ndryshe përpos tek neni 15.3 nga tarifa për leje mjete motorike lirohen të gjitha automjetet në pronësi të komunës, KFOR-it, UNMIK-ut, EULEX, Përfaqësuesit Diplomatik dhe emergjencës këtu e kemi shtuar edhe transportin e personave me aftësi të kufizuar por si duket teknikisht është harruar, normalisht gjithmonë provë duhet me qenë leja e qarkullimit duhet me pas një leje që e dëshmon që ky mjet është i komunës, apo organizatave tjera. Të Drejtoria e Gjeodezisë Kadastrit nuk mundemi me ndërhy sepse janë në bazë të udhëzimeve administrative, nëse keni mundësi të kalojmë te neni 17.18 të shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve ne kemi marr normalisht edhe prej bizneseve kërkesa kemi pas të dhëna të vazhdueshme dhe kemi

mendu që sipërfaqja e mbyllur ose publike që shfrytëzohet prej lokaleve nga 3euro të zbres në 2.50 euro ndërsa sipërfaqja e hapur ka mbetur e njejt ashtu siç ka qen, dhe të Komorani e kemi ulur po ashtu zonën e parë në qendër sipërfaqen e mbyllur prej 2 euro është bërë 1.5 euro dhe sipërfaqen e hapur prej 1 euro në 0.50 cent është propozim i komisionit. Tek drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport kemi shtuar një pasus te pika 19.13 nuk ka qenë më herët për shkolla sportive apo publike apo private të cilat janë të regjistruara dhe veprojnë në Komunën e Drenasit tarifat janë 70 % më lirë sesa në pikat 19.1 dhe 19.2 dhe po ashtu në faqen tjetër nga këto tarifa lirohen klubet sportive të regjistruara pran federatës së sporteve përkatëse të DKR-së dhe veprojnë në Komunën e Drenasit, Shoqatat e Dalura nga Lufta dhe OJQ-të e personave me nevoja të veçanta kjo nuk ka qenë më herët në rregullore dhe këto i kemi liruar. S ai përket nenit 19.18 tek Salla e Kutures, tek shfrytëzimi i sallës për tubime apo promovime të ndryshme me zerim 200 euro dhe 19.19 shfrytëzimi i sallës për tubime promovime të ndryshme me zerimin për qëllime humanitar, nevojave të institucioneve varëse të Komunës dhe bashke organizimeve të komunës më subjekte tjera është pa pagesë, këto dy nene i kemi shtuar. Sa i përket shërbimeve shëndetësore nuk kemi bërë ndonjë ndërhyrje me komision, kjo është krejt çka ne kemi bërë ndërhyrje në shumicën e taksave, ngarkesave tarifave gjë gjobave në interes qoftë për biznese qoftë për komunitete kemi bërë bashkëpunim edhe me kryetarin edhe me drejtoritë përgjegjëse, mos të harroj ta cekim se ne kemi ftuar secilen drejtorin që të paraqes kërkesat e tyre në lidhje me taksat pse duhet me qenë ajo taksë, mos të harroj edhe tek fusha e futbollit, ndeshjet sportive në stadion “Rexhep Rexhepi” nga 500 € sa kanë qenë e kemi bërë në 800 €.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj- a janë korporuar disa ndryshime si rezultat i ndryshimit sepse me pyeti z. Ruzhdi Lestrani.

Petrit Sinani- po janë korporuar, si rezultat ti udhëzimit administrativ ato ndryshime i kemi bërë, mirëpo pritet në rast se në janar miratohet rregullorja e re e cila në nivel qendror dhe e cila i heq komplet taksat sepse është propozim i gjitha komunave i heq gjitha taksat atëherë kjo bien, rregullorja në fuqi bien, ne e kemi për detyrë me e miratu këtë rregullore të cilën e kemi.

Sokol Bylykbashi- në bazë të asaj që e shikua dhe që e shpjegoi edhe kolegu kjo rregullore i shkon përshtati bizneseve që janë shumë fitim prurës dmth vetëm atyre iu përshtatet për shkak se po shoh zbritje, tek ordinancat shëndetësore ka qenë 600 €, 380 € tani, a ka ndonjë ordinancë shëndetësore që nuk ka punë kanë punë shumë dhe fatkeqësisht kanë punë për shkak se institucionet lokale mjekësore që i kemi janë të dobëta për këtë arsye kanë punë, sepse po të kishin qenë ato siq duhet sepse po të kishin ofruar shërbimet ashtu siç i lejon ligji këto ordianca sigurisht që do të kishin pas punë më pak 600 € me duket pak, këtu po e shikoj edhe tek ordianca stomatologjike edhe ato kanë punë shumë, dhe kjo zbritje është e panevojshme dhe kjo i shkon në dëm të hyrave vetanake komunale, për përmbaruesit privat gabim që i keni zbrit sepse në këtë kohë ata kanë punë shumë për shkak të grumbullimit të lendeve që është bërë dhe për shkak të mundësisë që e kanë nga aspekti ligjor që u ka dhënë mundësi më u merr me atë punë që e bëjnë aty dhe këto kanë fitim mjaft dhe sdi pse e keni zbrit, avokatura ka një zbritje kogja të madhe më shumë se 50 %, noteri ka zbritje edhe këta kanë punë mjaft nuk ka pas nevojë për

zbritje, po ashtu vërejtjet janë edhe për metalurgjinë keni aludua Feronikelin, pompat që janë në rrugë magjistrale.

Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- Sokol mua më pëlqeve me këto diskutime mirëpo nuk propozove me e rrit taksen por vetëm diskutove , propozoje me e rrit unë jam për me të përkrah dhe grupi parlamentar i PDK-së ka me të përkrah, pra unë jam kundër me ul këto çmime.

Sokol Bylykbashi- i kemi plane e kemi një dokument në fushën e shëndetësisë e kemi një dokument që e përmirëson dukshëm insutucionet tona lokale shëndetësore atëherë po ia bëjmë 600 jo por 700 €, nëse nuk kanë hesap le ti mbyllin.

Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- në magjistrale është çmimi shumë i vogël i taksës 2000 € kemi pompa të derivateve, kemi pompa të mjaftueshme të pompave të derivateve dhe unë nuk e konsideroj që u dashtë me ul takse, pra komisioni e ka marrë këtë vendim, kuvendi i vendos taksat këto janë vetëm propozime, grupi parlamentar i PDK-SË do t'ju përkrah.

Fitore Morina- dua të ndërlihem tek ordinancat shëndetësore edhe unë jam për me mbet çmimi që ka qenë ose me u rrit, në momentin që ka ndryshuar vitin e kaluar teksa ata e kanë ngrit çmimin për pacient, ose le ta bëjnë në rregullore ne e zbresim taksen ju zbritna çmimin sepse për ndryshe po pësojnë qytetaret. Po e lëmë taksen ashtu siç ka qenë.

Petrut Gashi- ju falënderoj që i keni marrë parasysh rekomandimet tona për me i rishqyrtuar edhe një herë këtë rregullore, unë që nga fillimi kam qenë ithtar i ndihmës së bizneseve në Drenas për arsye që Komuna Drenasit është shndërruar në Komunën më të varfër në Kosovë, aspekti ligjor qoftë i inave, qoftë i objekteve afariste, qoftë i bizneseve të ndryshme ajo nuk na takon neve ajo i takon ligjit dhe i takon qeverisjes në Drenas për me implementu ligjin dhe për këtë arsyeje me u pyet unë asnjë biznesi nuk i kisha vënë taksë së paku për një afat tre ose pesë vjeçar për arsyet që i ceka më lartë, Drenasi është me papunësinë ma të madhe, Drenasi është me numrin e bizneseve më të vogla të cilat për çdo vit shënon rënie të numrit të bizneseve në Drenas. Sa i përket rregullores tek neni 17.32, leja e përdorimit për objekte me koncesion, këtu thotë deri në sipërfaqe 450 metra katror objekti kolektiv me koncesion në afarizëm është 700 euro ndërsa 500 euro në banim, çdo tejkalim mbi 450 metra katror është përgjysmë afarizëm p.sh 1500 me 700 ose 700 me 300, nëse ka mundësi këtë me e ndryshuar leja e përdorimit të objekteve me koncesion deri në 450 metra me i lënë qysh i keni bërë të tjerat në vazhdimësi ndërsa prej 700 me zbrit 350 ose në 300 të banimit, të afarizmi është në rregull, por pasi i kena bërë këto shikone në vazhdim deri në sipërfaqe, tani taksa komunale mbi 450 metra katror atëherë afarizëm 1500 për banim është 700 edhe këtë të paren ndoshta ka qenë më mirë me e bërë 700 me 300.

Kryetari i komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- fjala është për pronë publike nuk është për pronë private, duhet me mbrojt taksen komunale, ia jep në shfrytëzim pronën komunale dhe thua me e ul taksen.

Petrit Gashi- nëse afarizmin e keni lënë 1000 për banim lënë 500.

Petrit Sinani- këto janë leje të cilat jepen për objektet me koncesion.

Florentina Elezi- e para është që biznesi individual me shumicë, sa ka me qenë e lehtë kjo në bazë të këtij afortimi dhe a ka me pas hapësirë për keqpërdorime, tek neni 13. 1, dhe a kini mundur për bizneset e reja që është 1 vit që lirohen prej taksës komunale, për shkak se i dina vështirësitë që i kanë bizneset vitin e parë të paktën dy vjet me qenë.

Egzona Jetullahi- ato biznese që kane mbi 5 të punësuar janë të liruar për tri vite ndërsa ato biznese që kanë një biznes individual që kanë më pak të punësuar ato ngarkohen.

Sokol Bylykbashi- për këto zbritje që i cekem me herët, cila është arsyeja pse i keni zbrit?

Kryetari i komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- unë nuk kam ndërhy ndonjë gjë gjatë hartimit të rregullores sepse rregullorja është duke u bërë në nivel vendi, dhe kur të hyn në fuqi ajo kjo rregullore do të bie, por mos me mbet pa rregullore sepse e kemi për obligim për qdo vit me e formu një rregullore dhe e kemi bërë, unë pajtohem me ty që për disa biznese me rrit për disa biznese apo veprimtari me e zbrit taksen komunale.

Burim Bujupi- fushat sportive që i kanë shkruar at 700 euro për mi dhënë në shfrytëzim për klubet tjera të cilat janë regjistruar në komunën e Drenasit ne kemi menduar që është taman për arsye se shumicën e rasteve kur ia kemi dhënë fushën në shfrytëzim edhe biletën e kanë marrë ekipet të cilat kanë ardh kanë luajtur në atë stadion, kështu që gjithçka është në rregull unë mendoj për këtë arsye e kemi rrit, nuk i marrim ne ato të hyra por i merr ekipi i cili zhvillon ndeshjen këtu, unë si anëtar i komisionit e kundërshtoj bashkëpunimin që po donë me bo kryetari me anëtarët tjerë të opozitës.

Adem Bucolli- unë pajtohem me parafolësit, edhe unë kërkoj që me mbet në fuqi taksa që me mbet ashtu siç ka qenë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës me ndryshimet që u ceken propozimin e z. Bylykbashi për vendosjen e çmimeve siç kanë qenë deri me tani, për ordianca, për avokat, për përmbarues, për noter për metalurgji, për feronikel për gurthyes dhe për pompat në rrugën magjistrale propozimi i z. Bylykbashi dhe z. Ademi që taksa me mbet e njëjtë, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit janë 22 anëtar,

Për votuan 19 anëtar

Abstenim votuan 00

Kundër votuan 03 anëtar.

Kryesuesi Labinot Halilaj -Hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës 6. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm Publik të pjesëve të ngastrave kadastrale, nëpër të cilat do të kalon rruga "Adem Jashari" e cila fillon nga Feronikeli nëpër Poklek, Korroticë e Ultë e deri në Korroticë të Epërme (të Kroni i Mbretit).

Drejtor për Kadaster dhe Gjeodezi Milaim Hajdari-në këtë pikë të renit të ditës kemi në propozim në shpalljes në interes të përgjithshëm pjesëve të ngastrave kadastrale nëpër të cilat do të kalon rruga "Adem Jashari" e cila fillon nga Feronikeli nëpër Poklek, Korroticë e Ultë e deri në Korroticë të Epërme (të Kroni i Mbretit). Të aprovohet propozim vendimi për shpalljen e këtyre parcelave me interes të përgjithshëm është me qëllim të realizimit të interesit publik të Komunës së Drenasit për projektin e ndërtimit të asfaltimit të rrugës tranzitore "Adem Jashari" e cila lidh Komunën e Drenasit me autostradën " Ibrahim Rugova" të rreth rrotullimit të Kroni i Mbretit në Korroticë të Epërme e komunës së Drenasit. Në arsyetimin e këtij propozim vendimi Komuna e Drenasit përkatësisht drejtorati për infrastrukturë publike sipas planifikimit të punëve ka paraparë edhe ndërtimin e asfaltimit të rrugës dhe atë rrugë tranzitore "Adem Jashari" e cila e lidh Komunën e Drenasit me autostradën "Ibrahim Rugova" të vendi i quajtur Kroni i Mbretit e cila fillon në Poklek dhe kalon nëpër Korroticë të Ulët dhe Korroticë të Epërme të rreth rrotullimi apo vendi i quajtur Kroni i Mbretit. Kjo rrugë tranzitore është e domosdoshme për qytetarët e komunës së Drenasit që të kenë lëvizje më të lehtë si dhe të shkarkohet segmenti I rrugës Komoran-Drenas. Ky segment rrugor do të kalon nëpër prona private dhe vetëm një pjesë është pronë shoqërore prandaj për ndërtimin e kësaj rruge medoemos duhet shpallur në interes të përgjithshëm publik të gjitha parcelat që janë prona private dhe në të cilat kalon ky segment rrugor. Sa i përket sipërfaqes që duhet shpronësuar kemi zonën kadastrale Poklek 7 hektar 43 Ari e 64 Metra, zona kadastrale Korroticë e Ulët me sipërfaqe 1 hektar e 11 Ari e 77 Metra dhe zona kadastrale Korroticë e Epërme 4 Hektar 51 Ari e 25 Metra. Ekipi profesional i drejtoratit për kadaster gjeodezi dhe pronë në bashkëpunim me drejtoratin për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit ka dal në vend shiqim dhe janë përcaktuar për incizimin e pjesës së ngastrave kadastrale të shënuara me lart ku do të bëhet ndërtimi, asfaltimi i rrugës për cilat pjesë edhe janë nxjerr edhe kopjet e planit edhe certifikatat mbi të drejtat e pronës, pas miratimit të këtij propozim vendimi kryetari i komunës inicion procedurën e shpronësimit të pronës palujtëshme së shënuar më lart në qeverinë e Republikës së Kosovës, me siguri e keni marr në material edhe elaburatin e shpronësimit të kësaj pjese. Ajo që vlen me shtu në këtë rast është që kryetari i komunës ka mbajtur një takim me banorët apo me pronarët e pronave të cilat preken nga projekti i ndërtimit të kësaj rruge. Me debatin me qytetar komuna ka njoftu palët apo pronarët e pronave të cilët preken për procedurat e shpronësimit, hapi i dytë që ndiqet pas takimit me banorët është shpallja e interes të përgjithshëm ose interes publik i kësaj rruge, momentin që kalon ky propozim vendim komuna përmes drejtorisë gjeodezisë kadastrale dhe pronë duhet të procedoj elaburatin e shpronësimit në ministrinë e financave, departamentin e tatimit në pronë , komisioni për vlerësimin e pronës së palujtëshme për të bërë vlerësimin e këtyre pronave. Komuna me këtë rast duke pasur parasysh se kjo është rrugë lokale është obligative të kryej shpronësimin mirëpo kjo nuk nënkupton që komuna do të insistoj përmes kryetarit që mjetet të sigurohen prej Qeverisë,

sidoqoftë që të jetë procedura në momentin që komuna e dorëzon në laboratin në ministrin e financave ata dalin komisioni i vlerësimit të pronave të paluajtshme është I vetmi institucion dikaster për vlerësimin e pronave të paluajtshme nivel komunës, ka rendësi për qytetaret dhe për ju që me ditë qmimi zakonisht merret çmimi i tregut por kjo nuk nënkupton dmth që vuhet një pikë dhe nuk bënë ndryshe. Në momentin që kthehet vlerësimi drejtoria për kadastrë është e obliguar me nxjerr vendimin për secilën pronë dhe secilën prone veç e veç, pajtohen me çmimin ecin procedurat, nëse nuk pajtohen me çmimin është mundësia me iu drejtu gjykatës për pa kënaqësitë e tyre. Ju ftoj me votu këtë propozim vendim sepse është një rrugë me interes, dhe këtë rrugë është bërë traseja, ne si komunë e kemi për obligim me i kry këto procedura me letra.

Kryesuesi Labinot Halilaj- rruga quhet “Adem Jashari” .

Petrit Gashi- edhe nëse është emëruar ajo ndoshta nuk ka problem, por problem është që është shkelje e ligjit sepse pa ekzistua rruga pa u kry shpronësimet dhe me ekzistua traseja e rrugës nuk emërtohen rrugët, por megjithatë unë i kam disa pyetje në lidhje me këtë rrugë sepse duhet me pas një raport fizibiliteti ne fakt se sa e frekuentojnë njerëzit atë rrugë, sa është kostoja e kësaj rruge, sa është kostoja e shpronësimit, në qoftë se kostoja e shpronësimeve mbulohet prej shpenzimeve komunale ashtu siq na prezantuat është një kosto bukur e lartë për atë pjesë ndoshta është e papërballueshme, frika është sepse ndoshta mos me shumë po kushton rruga sesa nevoja që është për atë rrugë .

Kryetari i komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- asnje gjë nuk është e papërballueshme, ju e dini, kjo rrugë nuk ka pas rrugë publike më heret, ks pas një fizibilitet të viteve të 70-ta për me e përdor për feronikelin, 2012 është dhënë tenderi është bërë fizibiliteti ka filluar projekti, një gjë duhet me kuptu pse e kam sjellë në kuvend me miratu shpronësimin e kësaj traseje, qytetaret i kemi pas ne debat kur kompania ka fillu me e zhvillu këtë projekt, janë 4 pronar që janë që na kan pengu mos me zhvillu krejt buxhetin, të cilin e kena nxjerr për këtë rrugë, a ma mirë me e bo rrugen të cilin e ka prej nivelit qendor, dhe që ne mendojme dhe besojmë se kemi me i nxjerr mjetet për shpronësim, për ndryshe se kemi me mbet pa rrugë që është në shërbim të qytetareve, prandaj sot keni para vete një elaborat të shpronësimit, një procedurë teper të vonuar për me mujt me i nis procedurat me i pagu niveli qendor, nuk e dina koston sepse është zyra për vlerësimin e shpronësimit në kuadër të ministrisë se financave ajo e cakton çmimin dhe pastaj ata pronar që nu kpajtohen e kanë të drejtën me e degu në gjyq por nu ke ka të drejten me kërkush me na humb buxhetin, ky vendim sot që e keni para jush e ruan parandë e komunës, e kursen dhe e mundeson ndertimin e rrugës trasesë e cila ka me qenë në shërbim e sidomos ka me qenë shumë në shërbim gjatë zhvillimit të punimit të rrugës 4 korsi.

Adem Bucolli – unë e falënderoj drejtorinë që na ka sjellë elaboratin për shpronësim, me mirëkuptim kërkoj mirëkuptim nga asambleistat dhe prej opozitës se është rrugë me prioritet, unë e kam një pyetje, kam kërkesë prej banoreve pronareve të pronave që pas shpronësimit, dmth shpalljes me interes të zonës kadastrale, vendimet kur munden me i marrë pronaret? Dhe e dina

rendesië e saj se se pari është për peshat e renda që po kalojnë neper qytet, une mendoj qëprioritet është nder to që lehtesohet komunikacioni.

Kryetari i komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- vendimet i marrin pasi ta bëjnë vlerësimin zyra për vlerësim, por banoreve unë iu kam thënë që une mundem me bo marreveshje me secilin se prona do t'ju paguhet do ta qojmë për shpronësim dhe do të kryhet ne kohen ma të shpejt prandaj ata të gjithë kanë thënë që traseja u bë shtrone rrugën nuk po iu pengojnë por paguna rrugën, por 4 pronar nje herë e kanë lëshuar me u bë traseja por pastaj na kanë penguar, dhe ne jemi detyruar që mos me hy neper pronë të tyre, momentin që ta votojmë elaboratin ma nuk mundet me nda ndal askush dhe pasi ta marrim vlerësimin ligjor nga MAPL-ja, kjo dmth mos me hargju buxhetin të cilin e ka caktuar niveli qendror dhe me e perfundu si rrugë dhe qytetareve me ia pagu pasurinë e vet.

Petrit Gashi- për rendësin e rrugës kemi diskutuar edhe me herët dhe shumë mirë nese behet ajo, por vetëm mos te krijon kosto tek ne me mund me i ik koston komunale që komuna mos me u ngarku shumë me shpronësimin për arsye se ndoshta na mbesin shumë projekte tjera ndoshta infrastrukture neper fshatra pa i përfunduar se është e papërballueshme sepse atë buxhet që e kemi duhet me nda për gjitha pjeset, e pse nëse sjellim grande dhe ki mundësi me sjelle investime nga niveli qendror ajo është krenari edhe për komunën sepse lehtësohet në të gjitha aspektet.

Kryetari i komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci, shqetësimi është sepse po ndërtojnë qytetaret neper trase por në rast se nëse nuk e shpronësojmë kush na garanton që vitin e ardhshëm nuk na merr përmbaruesi jo vetëm investimet kapitale por na i merr edhe pagat e zyrtareve, për këtë arsye ne e kemi sjelle kete propozim që me e shpronesu dhe me e përfundu këtë proces dhe me e përfundu edhe ministria sepse e ka obligim dhe e ka leju që nga fillimi që me investu dhe me e ndertu këtë rrugë.

Drejtori për Gjeodezi, kadaster dhe pronë Milaim Hajdari- në momenti që ky propozim vendim behet vendim ky është imun ndaj çdo veprimi që munden me bë qytetaret karshi gjykatës, është mirë që secilit qytetar me i tregu që nuk ka alternativ tjetër, çmimi i tregut ne gjithë jemi te vetëdijshëm se sa mundet me qenë çmimi, pjesën e parë të vitit 2020 mendoj se do të kryhen të gjitha procedurat, komuna për vitin që vjen i kem 1070 mijë euro që i kemi nda për prona të shpronësimit mirëpo ka investu ministria e infrastrukturës krejt mjetet duhet me insistu kryetari pasi kanë investu ata, ata e kan nis 2012 at rrugë që me i bartë ata shpenzimet e shpronësimit ka qen diçka jashtëzakonisht e mirë kaq kisha.

Kryetari i komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci-Njëfarë rregulle mbas 2012 nëse nuk gaboj qdo kërkesë që bëhet në ministri të ambientit dhe planifikimit për shpronësim e bën ajo, po para 2012 janë vetëm procedura gjyqësore nuk mudemi ne, nëse nuk jam gabim me vite.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Për votuan: 21 anetar

Abstenim votuan: 00

Kundër :00

Kryesuesi Labinot Halilaj- Hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:7. **Aprovimi i Planit të Punës për vitin 2020, i Kuvendit Komunal**

Florentina Elezi- Në rregullore të asamblesë kisha propozu që lista mos me u nënshkrua në fillim të seancës por në fund sepse numri i asamblistëve me kalimin e orëve po bien .

Kryesuesi Labinot Halilaj-Propozimi i zonjës Elezi ke shumë i drejt, por njërit mundën me lëviz por është mirë që ata që nënshkruhen me qenë prezent gjatë gjithë seancës. Atëherë hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Për votuan: 21 anetar

Abstenim votuan: 00

Kundër :00

Kryesuesi Labinot Halilaj- Hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: 8. **Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën afatmesme 2020-2024.**

Drejtoresha e zhvillimit ekonomik Egzona Jetullahi- Bazuar në statutin e komunës së Drenasit neni 4 pika 2 drejtoria e zhvillimit ekonomik ka hartuar draftin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për përdhën 2019-2024 në përputhje me strategjinë regjionale dhe atë qendrore duke i përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë si në sektorin afatshkurtër dhe në atë afatgjatë . Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal përcakton politikat e përballueshme dhe të arritshme në secilin sektor për arritjen e qëllimeve të politikës së qeverisjes lokale në periudhë afatmesme drejt asaj afatgjate për komunën drejt një horizonti të planifikuar pesë vjeçar . Përmes këtij dokumenti strategjik komuna e Drenasit paraqet vizionin, misionin dhe vendos qëllime strategjike, objektivat e matshme dhe mjetet për të orientuar Drenasin drejt një qyteti të zhvilluar Ky dokument përbën një detyrë të përbashkët për të zhvilluar Drenasin si shtet funksional të përkushtuar në përmasimin e jetës së qytetarëve në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik , rritjen e mirëqenies sociale, ofrimin e shërbimeve publike cilësore duke përfshirë arsimim, shëndetësinë si dhe promovimin dhe përkrahjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive . Pra strategjia adreson të gjitha problemet aktuale me të cilat ballafaqohet komuna dhe ofron zgjidhje praktike që përmisojnë pozicionin konkurrues së Drenasit në raport me komunat tjera, ngritjen e kapaciteteve qeverisëse duke përmisuar zbatimin e ligjeve, krijimin e klimës së partneritetit me biznese , krijimin e mundësive për aktivitete rinore dhe hapësirat e grupeve të marginalizuara. Ky dokument është hartuar nga një ekip i projektit të bashkëpunimit të ngushtë me egzekutivin

dhe stafin komunal, përfaqësuesve të komiteteve të biznesit dhe shoqatave bujqësore fermer dhe punëtor, po ashtu në aspektin e Arsimit si dhe Shëndetësisë po me shkollat e mesme të gjimnazit dhe nxënës të komunës së Drenasit, pra është një dokument i cili do të paraqet Drenasin për pesë vitet e ardhshme.

Sokol Bylykbashi- Ky dokument që quhet strategjia e zhvillimit ekonomik lokal , në bazë të asaj se çka përmban dokumenti shihet se flitet dhe për sektor të ndryshëm jo veç zhvillimit ekonomik tash nuk po e di a është kërkuar nga ju me bërë një dokument një strategji të zhvillimit vetëm për sektorin ekonomik apo për gjithë sektorët, nëse është vetëm për këtë sektor atëherë nuk e di pse duhet me figuru edhe çështja e arsimit ose ta zëmë shtirja e asfaltit, kanalizimit, kubëzat e kështu me radhë. Se tash dikush mundet më thënë ta zëmë me vendos një drit në shesh kjo ndikon në zhvillim ekonomik tash kjo është temë tjetër po veç këtë pyetje kam a është strategji vetëm për zhvillim ekonomik apo për të gjithë sektorët, nëse është për të gjithë sektorët është qenë mirë me ia ndërruar titullin strategjia e zhvillimit komunal.

Drejtoresha e zhvillimit ekonomik Egzona Jetullahi- z.Bylykbashi strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për përdhën afatmesme 2020-2024. Drejtorja e zhvillimit ekonomik i ka politikat ku hartohen punët e të gjitha drejtorive tjera që reflektohen në këtë dokument strategjik e cila do të paraqet punën e Drenasit për 5 vitet e ardhshme dhe këtu nuk mundem me fol vetëm për drejtorit e zhvillimit ekonomik por për një strategji të përgjithshme të të gjitha punëve të Drenasit. Janë të paraqitura të gjitha projektet për pesë vitet e ardhshëm përmes së cilave do të bëhen realizime të këtyre projekteve. Jemi mundu që të jetë një strategji e arritshme e jo si strategji letër pa keqkuptim ndoshta mund të them edhe si strategjitë e kalume, është obligative sepse strategjisë së kalume i skadon afati në fund të këtij viti dhe ne dëshirojmë që në vitin e ardhshëm të kemi këtë dokument relevant në të cilin do të ballafaqohet apo mund të paraqitet komuna e Drenasit.

Petrit Gashi- Në fakt nuk dojm me marr kohë me të metat e kësaj strategjike po flasim për strategjinë e zhvillimit ekonomik natyrisht bazohemi në një dokument apo në punë paraprake që bëjnë në bazë atyre rekomandimeve, ngecjeve apo përparësive e punëve tjera përpara ne ndërtojmë edhe strategjinë për të ardhmen. Unë kam disa pyetje të cilat mund më përmbledh sepse mendoj që ka të metat e veta sepse në dy vitet ne kemi një përshkrim se çka është bërë në dy vitet e kalume mirëpo nuk kemi diçka që kanë sjell diçka të re, edhe në qoftë se e shikon strategjinë e kaluar nuk janë arrit ato objektiva të asaj strategjie në këto dy mandate çfarë kryetari ika pas për pesëvjeçare, por edhe në këtë strategji nuk presim gjithçka të implmentohet. Si planifikoni ju nxitjen e ndërmarrjes të vogla dhe të mesme të cilën e keni përfshi në këtë strategji? Sa ka pasur investitor në dy vitet e kaluara në bazë të asaj çfarë është bërë në dy vitet e fundit ne ndërtojmë strategji për 2-4-5 vjet e ardhshme, dhe si planifikoni ju që të krijoni klimë për investime të huaja, klimë për këta investitor për me ardhur në Drenas. A kemi bërë fizibilitet për dy sektorët që janë më rendësi, ne shpesh e përmendim se sektori i bujqësisë dhe blegtorisë është i rëndësishëm, si e parashikoni ju që t'i nxitni qytetaret që të merren me këta dy sektor me

rendësi, dhe në cilët sektor e shihni më të rëndësishëm Komunën e Drenasit që duhet me i ftuar edhe invensitoret e huaj për me i nxit edhe qytetaret këtu që të investojnë në ata sektorë.

Drejtoresha e zhvillimit ekonomik Egzona Jetullahi- në fund të materialit e ke ku janë të gjitha objektivat, të gjitha ato pyetje që i bërë dhe aty e ke përgjigjen. Unë kisha kërkuar ty si asamblist dhe që i ke votat e qytetareve si një herë nuk e trokite derën time dhe me thënë që e dua këtë të mirë për qytetarin si nuk ishe as në dëgjim publik, se paku prej juve unë e kam pritur këtë. Në faqen e fundit i ke të gjitha objektivat. Sa i përket asaj se çka do të bëjmë për zhvillimin ekonomik e kemi zonën ekonomike rëndësinë primare do t'i ia japim e zonës ekonomike, po ashtu rendësi do t'i japim subvencioneve Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik po ashtu edhe nga Drejtoria e Bujqësisë rendësi të madhe do t'i japin startapeve baza e saj e cila është në zhvillim të hovshëm në Drenas, zhvillimi ekonomik i Drenasit mund të jetë qelës kryesor i qdo pamundësie për një vend pune, kështu që të gjitha objektivat i keni të cekura në këtë strategji në fund të këtij dokumenti. E kemi zgjerimin e parkut të biznesit në Drenas, zgjerimin e infrastrukturës kur ta zhvillojmë tek ai park atje, nderimi dhe funksionalizimi e atij paru, do t'i kemi bizneset në Drenas të cilat do t'u dhamë rendësi, do të kemi sektorin e grave të cilës do t'i dhamë rendësi edhe këtij sektori.

Petrit Gashi- drejtoresha këtu nuk është me tregu se kush ka drejtë me fol e kush është përfaqësues e kush jo, kjo nuk është përfaqësues i qytetarit kjo është e emëruar politike dhe çdo përgjigje që unë kërkoj për zhvillimin ekonomik dhe drejtorinë që përfaqëson kjo është e obliguar me u përgjigj para asamblistëve, nëpërmjet neve përgjigjet para qytetareve të komunës së Drenasit, pra asnjëra prej pyetjeve për Zhvillimin Ekonomik që i parashtrova psh si planifikoni ju që të krijoni klimë për investime të huaj, klimë për këta investitor për me ardh në Drenas, cili është një fizibilitet se sa ka kapacitete komuna e Drenasit me u marrë me sektorë të rëndësishëm si Bujqësia, Blegtoaria, Pemëtaria cilat janë asetet kryesore të cilat në i nxisim investohet e huaj me ardh këtu ose qytetaret me investu në ata sektorë, por në hapin e parë të përgjigjes se saj u kthye ne nje revansh të sulmojnë në asamblistë në mënyrë që të mos ia ndalim zërin dhe mos të përçon kërkesën e qytetareve tek ne, askush në Drenas as kryetari as këto që janë të emëruara politike nuk munden me na ndal zërin opozitareve këtu do ta përçojmë gjithë ata që mendojmë se nuk është mirë dhe nuk është e drejtë.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- me dhjetëra debate ju nuk keni marrë pjesë si rezultat i performances e cila ka me u shiku në janar është edhe një indikator që unë ka em e pas minus që ju nuk keni marrë pjesë, ju gjithë asamblistët në debat për buxhet nuk keni marr pjesë, dhe organizatat joqeveritare e kanë evidentua këtë fakt dhe ministria e ka kërkuar me shirku se sa kanë qenë aktiv asamblistët në këto debate, kemi minus pikë për këtë qeshje qe nuk keni marrë pjesë në debate, mirë ka qenë më marrë pjesë jo vetëm këtë debat për këtë strategji të zhvillimit ekonomik lokal për komunën tonë por dhe në debate tjera.

Petrit Sinani - unë personalisht kam qenë në dëgjim publik me kompaninë e kontraktuar dhe për te njëjtat pyetje që i shtroj edhe Petriti edhe më herët që u shtruan i kanë i kemi bërë edhe ne,

ne, kanë qenë pothuajse të njëjta, dhe ata me shumë korrektes na kanë sqarua se si kanë me u mundu me arrit Komuna e Drenasit këtë strategji për zhvillim ekonomik, në strategjinë e zhvillimit ekonomik vihet në pah edhe ndikimi indirekt i sektorëve nuk dmth që vetëm një drejtori direkt me pas ndikim, arsimi në formë indirekte ka ndikim në strategjinë e zhvillimit ekonomik, edhe shëndetësia edhe mirëqenia sociale dhe të gjitha dhe për ata kur kompania e ka bërë vlerësimin e ka marrë gjendjen aktuale e ka marrë e ka analizuar e ka bërë edhe një ekzaminim dhe një sfotoanalizë dhe kjo sfotoanalizë i jep edhe përparësitë edhe dobësitë dhe të mirat e Komunës së Drenasit të cilat ata i kanë marrë dhe normalisht e kanë bërë planifikimin për të ardhmen. Kompania ka qenë e gatshme me i spjegu të gjitha format sepse planin e ka bërë të matshëm dhe të arsyeshëm, ky dokument ndikon edhe në buxhet direkt, i kam lexuar edhe strategjitë më të mëhershme mirëpo ky dokument, dhe kjo kompani që e ka bërë është njëra ndër kompanitë më të mira hulumtuese në Kosovë kjo punon edhe projekte dhe ka bërë edhe projekte edhe komuna tjera dhe besoj që rast se kyçen gjithë arteret dhe mundet me qenë i implementueshëm por edhe ne si asamblist duhet me dhënë rolin tonë dhe drejtoritë .

Arta Xhyllani- e falënderoj drejtoreshën dhe grupin punues që ka punuar në strategjinë e zhvillimit ekonomik, zhvillimi ekonomik i përfshin të gjitha sferat prandaj quhet strategjia e zhvillimit ekonomik, vetëm një gabim teknik fq 22 shkolla “ Rasim Kiqina” e keni bërë vetëm Drenas po mendoj se duhet me qenë Drenasi II.

Kryesuesi Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës ku prezent ishin 21 anëtar
Për votuan 19 anëtar.
Abstenim votuan 02.
Kundër 00.

Kryesuesi Labinot Halilaj- Hapi diskutimin për piken e nëntë të rendit të ditës: 9. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Drenasit për nevoja të komunitetit të fshatit Sankoc.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovc- MAPL-ja e kanë bërë një rregullore dhe në atë draft rregullore nuk e parasheh që komuna ka të drejtë me iu dhënë komunitetit pronë për këtë qellim. Ne jemi munduar me e bërë me të mirën për qytetaret tanë dhe kemi menduar që ligji është në rregull por për këto e përcaktojnë në rregullore.

Kryesuesi Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës ku prezent ishin 22 anëtar:
Për votuan 22 anëtar
Abstenim votuan 00
Kundër 00.

Kryesuesi Labinot Halilaj- Hapi diskutimin për piken e dhjetë të rendit të ditës: 10. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Drenasit për nevoja të komunitetit të fshatit Komoran.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime **Kryesuesi Labinot Halilaj**- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës ku prezent ishin 22 anëtar:

Për votuan 22 anëtar

Abstenim votuan 00


Kundër 00


Kryesuesi Labinot Halilaj- Hapi diskutimin për të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi e konsideroj mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja Përfundoi në ora 15:22 min.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi

 **Kryesuesi i Kuvendit Komunal**
Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi komunal



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 24. 01 .2020, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K.P.F-ca se kemi edhe dy pika shtesë në rendin e ditës: 1. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar – dhjetor 2019. 2. Njoftim rreth përfundimit të kontratave të shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në Komunën e Drenasit. Të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan që të futet edhe këto dy pika shtesë në rendin e ditës, dhe u aprovua në mënyrë anonime nga të gjithë anëtarët rendi i ditës me:

Për votuan 07 anëtar, Kundër 00, dhe abstenim 00.

1.Betimi i asamblistit të ri Përparim Bajraktari nga Partia e subjektit politik- Vizioni për Drenasin, pas dorëheqjes se asamblistit Endrit Gllareva në Kuvendin Komunal Drenas. Të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan që edhe kjo pikë e rendit të ditës të kalon për kuvend .

2.Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.12.2019.

-U miratua në mënyrë anonime me:

Për votuan 07 anëtar, Kundër 00, dhe abstenim 00 .

3.Draft Propozim strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal 2020 -2024.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime dhe kjo pikë e rendit të ditës u votua në mënyrë anonime: *Për votuan 07 anëtar, Kundër 00, dhe abstenim 00.*

4. Propozim Vendim për shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Drenasit për periudhën 2020-2028.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime dhe kjo pikë e rendit të ditës u votua në mënyrë anonime: *Për votuan 07 anëtar, Kundër 00, dhe abstenim 00.*

5. Plani vjetor i Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale për vitin 2020.

Kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua të kaloi në Kuvend.

6. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2019:

Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.

Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend.

7. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar – dhjetor 2019.


Kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua të kalojnë për Kuvend.

8. Njoftim rreth përfundimit të kontratave të shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në Komunën e Drenasit.

- Kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend.

9. Të ndryshme.

Burim Bujupi- njoftoi se si afetar i komisionit për emërtim të rrugëve jemi duke punuar në teren për shqyrtim të kërkesave për emërtim të rrugëve, kërkoj se a duhet të raportojmë për çdo seancë, apo një raport përfundimtar.


Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



01- Nr 030-2061 dt. 16/01 2020


DRAFT PROPOZIM
STRATËGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020 - 2024

JANAR 2020

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (i) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gaz.Zyrt. e Republikës së Kosovës"), nenit 34.6 pika të Statutit të Komunës së Drenasit; me nr; 01-110-6904 të dt; 24.09.2008, Dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në bazë të nenit nenit 4 paragrafi 2 të Ndryshim Plotësimi i Statutit të Komunës së Drenasit me nr: 12-030-19523 të dt;06.04.2018, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.04/2018 për Transparencën në Komuna, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dispozitave të Rregullores Nr.01/2017 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, dispozitave të Rregullores (QRK)Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dispozitave të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën __.01.2020 të aprovoj:

STRATËGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Ky dokument strategjik përcakton objektivat dhe veprimet e planifikuara komunale që duhet të ndërmerren në fushat të ndryshme të ndërlidhura me politikat të cilat adresojnë problemet e caktuara për periudhen kohore 2020-2024.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01- Nr 030/01- 699/0 dt. 06/11/ 2019

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 4 paragrafi 2 të Ndryshim Plotësimit të Statutit të Komunës Nr.12-030-19523, të datës 06.04.2018, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Themelimin e Ekipit Komunal për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal për periudhën afatmesme 2020-2024

1. Anëtarët e Ekipit Komunal për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal për periudhën afatmesme 2020-2024 janë:

1. Egzona Jetullahi, Drejtor i DZHE-së,
2. Shehrije Mustafa, (koordinatorë),
3. Besim Tahiraj, (anëtarë),
4. Halime Bardhi Zenelaj, (anëtarë),
5. Besart Bajrami, (anëtarë),
6. Shaban Dobra, (anëtarë),
7. Afrim Prokshi, (anëtarë),
8. Hazir Elshani, (anëtarë),
9. Shqipe Kuliqi, (anëtarë),
10. Agim Kastrati, (anëtarë),
11. Ahmet Ahmeti, (anëtarë),
12. Safet Hoxha, (anëtarë),
13. Lumturije Kiqina, (anëtarë),
14. Ruzhdi Lestrani, (anëtarë),
15. Haki Bekolli, (anëtarë),
16. Skender Hasi, (anëtarë),
17. Blerim Nika, (anëtarë),
18. Bekim Dobra, (anëtarë),
19. Haxhi Lladrovci (Përfaqësues i bizneseve), (anëtarë),
20. Arben Nika (Shoqëria Civile), (anëtarë),
21. Florim Hajdari (KEDS), (anëtarë),
22. Muhamer Qelaj (Pastrimi), (anëtarë),
23. Ismet Baliu (Ujesjellesi), (anëtarë).

2. Ekipit Komunal për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal ka këto përgjegjësi:

- të sigurojnë të dhënat nga departamenti /institucioni i tyre,
- të marrin pjesë në takime të rregullta konsultative për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL),
- të japin ekspertizë profesionale në analiza sektoriale,
- të informojnë vendimmarrësit për procesin e hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL),
- të llobojnë për miratim final të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL).

3. Ekipit Komunal për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lart dhe përkushtim.

4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës


Ramiz Lladrovci


Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Ekipit Komunal për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.



Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024





Komuna e Glogocit

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020 – 2024

Dhjetor 2019

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Përmbajtja

Lista e figurave	4
Ekipi Punues	5
Fjala e kryetarit	6
Hyrje	7
Metodologjia	8
Gjendja Aktuale	8
Ekzaminimi Sektorial	10
Planifikimi Strategjik	10
Të dhënat gjeografike dhe demografike	11
Sektori privat	12
Demografia e bizneseve në Drenas	12
Tregtia	13
Prodhimtaria	13
Sfidat e sektorit privat në Drenas	14
Bujqësia	15
Sektori i pemtarisë dhe perimtarisë	15
Sektori i Bletarisë	17
Sektori i Blegtorisë	17
Arsimi	20
Menaxhimi i arsimit dhe administratës	21
Sigurimi i Cilësisë	22
Mjedisi Shkollor	22
Zhvillimi profesional i mësimeve	24
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	25
Sektori i shëndetësisë	25
Mirëqenia Sociale	27
Ambienti dhe shërbimet publike	28
Menaxhim i mbeturinave	28
Infrastruktura	28
Kultura, Sporti dhe Turizmi	29
Kultura	29
Sporti	29
Turizmi	30
ADMINISTRATA	31
Trajnimet dhe Zhvillimi	31

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Sistemet e menaxhimit	31
Ofrimi i shërbimeve	32
Vlerat.....	33
Vizioni.....	34
Misioni.....	34
Objektivat Strategjike dhe Hapat Kryesor.....	34

Lista e figurave

- Figura 1 Skema metodologjike
- Figura 2 Popullësia sipas gjinis dhe grupmoshës në %
- Figura 3 Bizneset sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %
- Figura 4 Bizneset në sektorin e tregtisë sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %
- Figura 5 Bizneset në sektorin e prodhimit sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %
- Figura 6 Pemët në tokë të punueshme sipas kulturës
- Figura 7 Pemët në tokë të punueshme sipas kulturës
- Figura 8 Kullotja e bagëtisë sipas pronsisë së kullotave
- Figura 9 Madhësia e kopesë në ekonomitë bujqësore
- Figura 10 Madhësia e tufës së shpendëve në ekonomitë bujqësore
- Figura 11 Numri i përgjithshëm i nxënësve sipas viteve shkollore
- Figura 12 Raporti nxënës/mësimdhënës sipas viteve shkollore
- Figura 13 Personeli shkollor sipas përgaditjes akademike
- Figura 14 Gjendja e objekteve shkollore
- Figura 15 Gjendja e inventarit në shkolla
- Figura 16 Kabinetet e punës / dhe laboratorët sipas disponueshmërisë dhe funksionalitetit në shkolla
- Figura 17 Gjendja e objekteve shëndetësore
- Figura 18 Disponueshmëria e hapsirave të mjaftueshme në institucione shëndetësore sipas kornizës ligjore
- Figura 19 Disponueshmëria e paisjeve medicinale të nevojshme sipas institucioneve shëndetësore
- Figura 20 Numri i vizitave mjekësore në institucionet shëndetësore
- Figura 21 Numri i përfituesve sipas skemave pensionale dhe sociale
- Figura 22 Infrastruktura publike sipas %
- Figura 23 Numri i punëtorëve sipas nivelit të edukimit dhe kategorisë funksionale

Ekipi Punues

Anetarët e Ekipit Komunal për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal për periudhën afatmesme 2020 – 2024:

Egzona Jetullahi, Drejtor i DHZE
Shehrie Mustafa, Koordinate
Besim Tahiraj, Anëtar
Halime Bardhi – Zenelaj, Anëtare
Shaban Dobra, Anëtar
Afrim Proshki, Anëtar
Hazer Elshani, Anëtar
Shqipe Kuliqi, Anëtare
Agim Kastrati, Anëtar
Ahmet Ahmeti, Anëtar
Safet Hoxha, Anëtar
Lumnije Kicina, Anëtare
Ruzhdi Lestrani, Anëtar
Haki Bekolli, Anëtar
Skenderaj Hasi, Anëtar
Blerim Nika, Anëtar
Haxhi Lladrovci, Përfaqësues i bizneseve
Arben Nika, Shoqeri civile
Florim Hajdari, KEDS
Muhamer Qelaj, KRMM
Ismet Baraliu, KUR
Violeta Baleci, Menaxhere e projektit

Anëtarët e ekipit të projektit nga kompania implementuese MDA:

Luan Dalipi – Udhëheqës i ekipit të MDA-së
Hamit Qeriqi – Ekspert në politika lokale dhe zhvillim të qëndrueshëm
Ylber Beqiri – Ekspert i planifikimit strategjik
Bardhyl Musa – Menaxher i projektit
Donika Veseli, Flutra Bislami - Hulumtuese

Fjala e kryetarit

Të nderuar qytetarë,

Qeverisja Komunale është e përkushtuar që në vazhdimësi të angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm, përmes investimeve dhe projekteve në infrastrukturë, bujqësi, përkrahje të bizneseve të reja, arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, kulturë, rini e sport. Shpeshherë, mundësitë buxhetore na kufizojnë që të realizojmë të gjitha projektet e nevojshme për qytetarët dhe bizneset. Megjithatë, ne jemi të përkushtuar që në këto kushte, të bëjmë më të mirën për qytetarët dhe komunën tonë.

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal paraqet një dokument strategjik të bazuar në plan të veprimit, që ka për synim zhvillimin ekonomik. Ky plan do të përcaktojë rrugën për të bërë realitet vizionin tonë për Drenasin si çelës i suksesit, për bizneset dhe qytetarët e tij. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 është udhërrëfyes për (i) përmirësimin e vazhdueshëm të ambientit të sektorit privat dhe nxitjen e zhvillimit të hovshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik, (ii) fuqizimin e qytetarëve për t'a realizuar potencialin e tyre të plotë, përmes sigurimit të mundësive të barabarta në arsim, shëndetësi dhe jetë sociale cilesore, dhe (iii) përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit njerëzor dhe financiar, bazuar në praktikatat e mira ndërkombëtare të qeverisjes lokale.

Besoj fuqishëm që ky dokument strategjik do të shërbejë si orientim për zhvillim të mundësive dhe potencialeve që posedon komuna jonë.

Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit



Hyrje

Përmes këtij dokumenti strategjik Komuna e Drenasit paraqet vizonin dhe misionin, vendos qëllimet strategjike, objektivat e matshme dhe mjetet për ta orientuar Drenasin drejt një qyteti të zhvilluar. Ky dokument poashtu përbën një detyrë të përbashkët për të zhvilluar Drenasit si qytet funksional, të përkushtuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve, në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e mirëqenies sociale, ofrimin e shërbimeve publike cilësore, përfshirë arsimin dhe shëndetësinë, si dhe promovimin dhe përkrahjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Në 20 vitet e fundit Drenasi është sfiduar nga infrastruktura e dobët, Industria e pazhvilluar, objekte shkollore të vjetruara, shërbimeve joadekuate shëndetësore që kanë rënduar edhe më shumë jetën sociale të qytetarëve. Në këtë periudhë, thuajse i tërë buxheti komunal është shpenzuar në rimëkëmbjen e infrastrukturës publike dhe ndërtimit të institucioneve tjera vitale për funksionim normal të komunës.

Aktualisht, në komunën e Drenasit sfida kryesore mbeten zhvillimi i ulët i sektorit të prodhimit, modernizimi i fermave dhe kultivimi i produkteve bujqësore me vlerë të shtuar, sigurimi i cilësisë në arsim dhe mjedis shkollor, ofrimi i shërbimeve sociale cilësore, rritja e numrit të shërbimeve nga institucione e kujdesit primar shëndetësor, si dhe zhvillimi i kulturës dhe sportit.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal adreson të gjitha problemet aktuale me të cilat ballafaqohet komuna, dhe ofron zgjidhje praktike që përmirësojnë pozicionin konkurrues të Drenasit në raport me komunat tjera. Në pajtueshmëri me pozicionin e synuar konkurrues dhe mundësive buxhetore janë përcaktuar synimet dhe objektivat për periudhën 2020-2024.

Ky dokument është hartuar nga ekipi i projektit në bashkëpunim të ngushtë me ekzekutivin dhe stafin komunal, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe shoqatave bujqësore, fermerë dhe punëtorë të arsimit, shëndetësisë dhe nxënës.

METODOLOGJA

Metodologjia

Qëllimi i strategjisë është inkorporimi i saj në drejtoritë përkatëse, nëpërmjet mbledhjes së të dhënave të nevojshme për Komunën e Drenasit si dhe shëndërrimi i të dhënave në informata relevante për marrjen e vendimeve të nevojshme nga ekzekutivi i Komunës.

Strategjia paraqet një platformë strategjike dhe aksionale, që ka për synim zhvillimin ekonomik, për nevojat e sektorëve dhe vendimmarrësve në Komunën e Drenasit.

Për hartimin e strategjisë janë përdorur metoda kualitative dhe kuantitative në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

Fazat e përshkruara më poshtë janë kyçe në hartimin e strategjisë në fjalë.




Figura 1 Skema metodologjike

Gjendja Aktuale

Për analizimin e gjendjes aktuale janë mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore në të gjitha drejtoritë e Komunës së Drenasit në mënyrë që të identifikohen të arriturat dhe ngecjet e deritanishme në Komunë. Për të implementuar këtë aktivitet janë përdorur pyetësorë dhe intervista me të gjitha drejtoritë, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Komunës.

Si fazë fillestare e hartimit të strategjise është përgaditja e mjeteve për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Gjatë kësaj faze janë identifikuar të dhënat e nevojshme për një analize të mirëfilltë mbi gjendjen e sektorëve ekonomik dhe social. Për këtë janë zhvilluar formularë me të dhënat në vijim:

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Administratë: Lista e stafit më të dhenat: Drejtoria; Kategoria funksionale; Grada; Titulli; Moshë; Paga; Kualifikimi; Gjinia

Arsimi: Numri i nxënësve; Stafi i Angazhuar (administrative/akademik); Numri i stafit akademik sipas përgaditjes shkollore; Numri i nxënësve sipas largësisë së udhëtimit; Infrastruktura bazike (Furnizimi i shkollës me ujë; Ngrohja; Qasja në kanalizim; Gjendja e objektit; Gjendja e Inventarit; Nr i dhomave të mësimi (Klasave); Posedimi i mjetve konkretizuese dhe kabinetet; Mesatarja e notës së nxënësve për shkollën/paralelen; Mesatarja e pikëve në testin e aritshmërisë.

Bujqësia: Sipërfaqja e mbjellur për secilën kulturë bujqësore, numri i fermerëve, numri i ekonomive bujqësore, kategorizimi i tokës, sipërfaqja me kullosa.

Urbanizëm dhe Shërbime Publike: Numri i rrugëve, gjatësia e rrugëve, gjatësia e rrugëve të asfaltuara, kubëzuar dhe në zhavor, gjatësia e kanalizimit fekal, atmosferik, trotuareve, ndriçimit publik dhe ujësjellësit

Zhvillim Ekonomik: Numri i bizneseve të regjistruara, numri i bizneseve aktive, vlera e qarkullimit për sektor dhe nënsektor, numri i punëtorëve për sektor dhe nënsektor; vlera e eksportit për sektor dhe nënsektor;

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale; Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale; Pensionet bazike të moshës; Skema e pensioneve për veteranët e luftës; Pensionet kontribut pagues të moshës; Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale; Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës; Pensionet e personave me aftësi të kufizuara; Skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara (0-18) vjeç; Pensionet Invalidore të punës; Numri i objekteve shëndetësore, gjendja e tyre, numri i vizitave, numri i ofrimit të shërbimeve, frekuenca e shërbimeve sipas viteve.

Kulturë, Rini dhe Sport; Numri i organizatave jo-qeveritare rinore, numri i shfaqjeve dhe performancave artistike në shtëpinë e kulturës; numri i klubeve sportive sipas llojit të sportit

Për hartimin e strategjisë, ekipi i projektit është bazuar në dokumente ligjore siç janë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës, Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Drenasit dhe dokumente të tjera relevante. Poashtu, janë shqyrtuar dhe analizuar strategjitë e ndryshme të prodhuara më herët nga organizata të ndryshme në lidhje me zhvillimin e Drenasit (Strategjia e Zhvillimit Ekonomik 2015-2019, Draft plani zhvillimor i Drenasit 2020-2027). Gjithashtu, janë konsultuar dokumente të tjera shkencore që kanë në fokus turizmin, atraksionet dhe kapacitetet bujqësore të komunës së Drenasit.

Ekzaminimi Sektorial

Në mënyrë që të identifikohen pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe rreziqet në secilën drejtori, është zhvilluar një SWOT analizë përmes intervistave të drejtpërdrejta me drejtorët e drejtorive të Komunës së Drenasit.

Zhvillimi i kësaj analize është përcaktuar nga analiza "7S" përmes së cilës identifikohen kapacitetet dhe ngecjet e një organizate apo institucioni të caktuar. Analiza 7S identifikon të dhënat si në vijim: *Strukturën e organizatës; Sistemin udhëheqës; Stilin e udhëheqjes dhe vendimmarrjes; Kapacitetet e stafit; Aftësitë e drejtorisë në fjalë; Strategjia e punës; dhe Vlerat e përgjithshme.*

Për më tepër, identifikimi i mundësive dhe rreziqeve për t'u zhvilluar është bërë përmes analizës PESTEL, e cila e vë në korrelacion zhvillimin e Komunës me aspektet: *Politike; Ekonomike; Shoqërore; Teknologjike; Mjedisore; dhe Ligjore.*

Planifikimi Strategjik

Pas procesit të mbledhjes së të gjitha informatave sasiore dhe cilësore janë ndërmarrë hapa konkret rreth hartimit të strategjisë. Pas analizimit të të dhënave të mbledhura nga intervistat, hulumtimeve sekondare, analizimit të të dhënave statistikore dhe analizës sektoriale, është krijuar një pasqyrë që ka reflektuar në gjendjen aktuale në sektorët e analizuar të zhvillimit ekonomik të komunës së Drenasit.

Për hartimin e strategjisë është mbajtur një punëtori dy-ditore me ekipin punues. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte analizimi i të dhënave dhe vendosja e prioritetëve dhe qëllimeve strategjike, objektivave specifike/projekteve/masave që duhet të ndërmerren për realizimin e vizionit të komunës së Drenasit.

Të dhënat gjeografike dhe demografike

Komuna e Drenasit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina, 110 km nga Shkupi dhe 230 km nga Tirana. Territori i saj, shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Për nga sipërfaqja, Komuna e Drenasit përfshinë një sipërfaqe prej 275,63km² me një lartësi mbidetare prej 575 m deri 1072 m.

Komuna e Drenasit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug- Perëndimore, Kasmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug-Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica. Drenasi kufizohet me Vushtrrinë dhe Obiliqin në verilindje, me Fushë Kosovën dhe Lipjanin në lindje, në jug me Suharekën, në jugperendim me Klinën, dhe në veriperendim me qytetin e Skenderajit.

E një rëndësie të veçantë për komunën e Drenasit është miniera dhe shkretorja e "Feronikelit". Nëpër këtë komunë kalojnë lumi Drenica dhe Vërbica, uji i të cilave shfrytëzohet për ujitjen e tokave bujqësore.

Nga aspekti i transportit rrugor, komuna e Drenasit lidhet përmes hekurudhës me Fushë Kosovë-Pejë dhe rrugën magjistrale Prishtinë – Pejë, dhe rrugët regjionale R7 Autostrada Prishtinë – Prizren – Tiranë.

Komuna e Drenasit ka klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohtë dhe verë të ngrohtë, me temperaturë mesatare vjetore 10.6 °C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, ndërsa muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është rreth 670 mm në vit, kurse lartësia mbidetare është prej 500-650m. Afërsisht gjysma e territorit të komunës së Drenasit gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi kjo mjaft e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë.

Në bazë të vlerësimit të popullsisë të realizuar në vitin 2012, rezulton që numri i popullsisë në Komunën e Drenasit ka qenë 59,752 banorë, nga të cilët 51% i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 49% gjinisë femërore.





Figura 2 Popullsia sipas gjinis dhe grupmoshës në %

Në bazë të grafikut të paraqitur më lartë, mosha e re 0 - 14 vjeç përbën 29.5 % të popullsisë së Drenasit, kategoria e grupmoshës 15 - 64 merr pjesë me 64.8%, kurse mosha mbi 65 vjeç me rreth 5.6 % të popullsisë së përgjithshme. Nga kjo që u tha më lartë, mund të vijmë në përfundim që grupmoshat e popullsisë 15 – 64 vjeç dominojnë në popullatën e përgjithshme.



SEKTORI PRIVAT

Sektori privat

Në komunën e Drenasit zhvillimi i sektorit privat që nga paslufta kryesisht është perkrahur nga donatorët dhe projektet ndërkombëtare, megjithatë roli i bizneseve, e posaçërisht i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) ka qenë i lartë në zhvillimin ekonomik lokal, sidomos në krijimin e vendeve të punës. Për më tepër, krijimi dhe funksionalizimi i Parkut të Biznesit ka ndikuar në rritjen e investimeve vendore dhe të huaja, por edhe në krijimin e vendeve të reja të punës.

Demografia e bizneseve në Drenas

Komuna e Drenasit numëron gjithsej 3921 biznese të regjistruara, prej të cilave 1259 apo 32% janë aktive. Kjo gjendje në raport me nivelin kombëtar ndryshon për rreth 11% ku raporti në mes bizneseve të regjistruara dhe atyre aktive është 23%.




Figura 3 Bizneset sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %

Nga numri i bizneseve aktive me seli në Komunën e Drenasit 31.97% bëjnë pjesë bizneset nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë, 16.93% sektori i prodhimit dhe sektori i ndërtimit me 18.69%.

Sa i përket shitjeve, bizneset e Drenasit pranojnë dhe kryejnë transaksione si total mesatarisht nga 150 milion Euro deri në 180 milion Euro në vit. Në raport me nivelin kombëtar, vlera e transaksioneve të bizneseve të Drenasit është rreth 1.6%. Nga viti 2016 deri në vitin 2018, vlera e qarkullimit ka pasur një rritje mesatare vjetore prej 15%, kurse rritja e përgjithshme ka shënuar 32%. Vlen të theksohet që sektori i shërbimeve administrative dhe mbështetjes dhe sektori i komunikimit dhe informimit kanë shënuar rritjen më të lartë mesatare vjetore. Tregtia mbetet si sektori më i madh sa i përket vlerave të qarkullimit me 48.64%, minierat dhe guroret me 28.40% dhe prodhimi me 11.59%.

Bazuar në të dhënat e Trustit Pensional të Kosovës, në total rreth 12000 persona janë kontributdhënës të rregullt në Komunën e Drenasit, kurse bizneset e Drenasit numërojnë rreth 3168 persona të punësuar në vitin 2018. Nga viti 2016 deri në 2018, rritja mesatare vjetore e punësimit është 5% kurse rritja e përgjithshme 10%. Sektorët me përqindje më të lartë të punësimit janë: tregtia me shumicë dhe pakicë me 28%, minierat dhe guroret me 27% dhe sektori i prodhimit me 13%.

Tregtia

Tregtia është njëri ndër sektorët më të zhvilluar dhe të rëndësishëm në komunën e Drenasit, gjithsej 219 kompani operojnë në sektorin e tregtisë:




Figura 4 Bizneset në sektorin e tregtisë sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %

Nën-sektori i tregtisë me pakicë në komunën e Drenasit është më i zhvilluar se sa nën-sektori i tregtisë me shumicë. Siç shihet edhe në grafikonin e paraqitur më lartë, numri i bizneseve që merren me tregti me pakicë është dukshëm më i lartë, por poashtu, ky nën-sektor arrin të punësojë rreth 55%, respektivisht të punësojë 10% më shumë se nën-sektori i tregtisë me shumicë.

Prodhimtaria

Sektori i prodhimit në komunën e Drenasit përbëhet nga gjithsej 116 biznese prodhuese aktive, prej të cilave 22% janë biznese që merren me prodhimin e produkteve minerale jometalike, ndërsa 17% me prodhimin e produkteve ushqimore. Sa i përket punësimit, nën-sektori i prodhimit të produkteve minerale jometalike dhe nën-sektori i prodhimit të produkteve të gomës dhe plastikës përbën rreth 44% të punësimit në këtë sektor.




Figura 5 Bizneset në sektorin e prodhimit sipas shpërndarjes, punësimit dhe qarkullimit në %

Edhe pse komuna e Drenasit ka një numër të lartë të fermerëve të regjistruar dhe aktiv, numri i bizneseve aktive në sektorin e bujqësisë mbetet shumë i vogël. Aktualisht, 46 biznese janë aktive në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë.

Sfidat e sektorit privat në Drenas

Ashtu si në të gjitha komunat tjera, edhe në komunën e Drenasit një ndër sfidat kryesore të sektorit privat mbetet prania e madhe e ekonomisë joformale, qoftë nga aspekti i deklarimit të punëtorëve, poashtu edhe në aspekt të pagesës së tatimeve dhe pajtueshmërisë ligjore. Ky fenomen e bën shumë të vështirë për kompanitë që veprojnë konform ligjit që të konkurrojnë në të njëjtin ambient me ato kompani që për një arsye apo tjetër operojnë në mënyrë joformale.

Mungesa e shkathtësive më së shumti vërehet në sektorin e prodhimit, kryesisht përshkak të mungesës së punës praktike tek të rinjtë e interesuar për punë. Një përqindje shumë e madhe e bizneseve nga sektorët e prodhimit po hasin më shumë vështirësi në rekrutimin e punëtorëve me aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme. Bizneset nga sektori i prodhimit kanë vështirësi në gjetjen e punëtorëve me kualifikime specifike, që janë të nevojshme në procese të prodhimit, si: saldues, makinist, zdrukthar, teknik të ushqimit, etj. Sektorët e prodhimit kërkojnë shkathtësi më specifike të nevojshme për atë industri specifike. Nga intervistat dhe takimet që kemi realizuar, kemi kuptuar që bizneseve prodhuese në Drenas ju nevojiten afërsisht më shumë se 3 muaj për të aftësuar një punëtor me shkathtësitë që i nevojiten në vend të punës. Për më tepër, trajnimi i punëtorëve të rinjë paraqet shpenzim të lartë për bizneset, por njëkohësisht ata nuk kanë garanci që personat e trajnuar do të qëndrojnë të punojnë në bizneset e tyre.

Eksportet e bizneseve të Drenasit janë të konsiderueshme, ku rreth 10-15% të qarkullimit të tyre total gjenerohet nga eksportet, ndërsa synimi primar i tyre mbetet depërtimi në tregje rajonale dhe evropiane. Në raport me tregtinë ndërkombëtare, për bizneset e Drenasit sfidë kryesore e tyre mbetet gjetja e tregjeve të huaja, ndërtimi i kapaciteteve të brendshme për eksport, planifikimi i eksporteve, çertifikimi i produkteve dhe kompanive të tyre me standard të cilësisë si: ISO 9001:2015; ISO 14001; ISO 22000/HACAP; ISO 27001, CE mark, etj.

BUJQËSIA

Bujqësia

Bujqësia në komunën e Drenasit është ndër sektorët që ka ndikim të madh dhe të rëndësishëm në ofrimin e mundësive në punësim dhe në krijimin e të ardhurave për ekonomitë familjare. Megjithatë, zhvillimi i bujqësisë në komunën e Drenasit në raport me aftësitë konkurruese në tregut rajonal dhe të BE-së mbetet në nivel të njëjtë edhe me komunat e tjera. Shkaqet kryesore të këtij nivel të ulët konkurrues janë mungesa e njohurive rreth teknologjisë bashkëkohore të prodhimit dhe sigurimit të blerësve në tregjet rajonale dhe evropiane, mungesa e agronomëve dhe marrja e këshillave bujqësore, mungesa e pajisjeve për klasifikim dhe paketim të produkteve bujqësore, kosto e lartë e prodhimit, dhe mungesa e përkrahjeve grumbulluese për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore. Për më tepër, vlen të theksohet që një nga problemet kryesore me të cilat ballafaqohen fermeret në komunën e Drenasit është pamundësia e gjetjes së tregjeve vendore për shitjen e produkteve, procesi i komestacionit të tokave bujqësore, sipërfaqe të vogla të tokave nën ujë, si pasojë e mos funksionalizimit të kanalit të ujitjes së lber Lepencit dhe mungesa e promovimit të produkteve bujqësore, paraqesin disa nga sfidat kyçe të zhvillimit të bujqësisë.


Duke u nisur nga fakti që numri më i madh i ekonomive bujqësore në komunën e Drenasit për nga madhësia e kapaciteteve prodhuese/kultivuese/përpunues është i vogël, do të ishte e rekomandueshme që të inkurajohet edhe bashkëpunimi horizontal ndërmjet ekonomive bujqësore me qëllim ngritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimin e cilësisë. Poashtu, rekomandohet që të lehtësohet bashkëpunimi i ekonomive bujqësore me zinxhirin e përpunimit dhe të shitjes (psh., prej 'qumshtit vendor' tek 'fabrika përpunuese' tek 'ndërmjetësuesi për shitje të produkteve të qumshtit në tregun vendor dhe ndërkombëtar').

Si përfundim, është shumë e nevojshme që të rritet numri i agronomëve përmes të cilëve do të bëhet avansimi i metodave të kultivimit dhe përpunimit tek fermerët ekzistues. Gjithashtu, të rritet numri i fermerëve të rinj të moshës prej 18 deri 40 vjeç nëpërmjet stimulimit me subvencione dhe grante.

Sektori i pemtarisë dhe perimtarisë

Në bazë të Regjistrimit të Bujqësisë të bërë në vitin 2014, është parë që janë rreth 112 ha (apo rreth 155,227 trupa të pemëve), që mbillen me pemë në Komunën e Drenasit. Mollat dhe kumbullat janë kulturat më të shpeshta që kultivohen nga ekonomitë bujqësore, me gjithsej 75% mollë dhe 15% kumbulla nga totali i sipërfaqeve të mbjellura në tokë të punueshme. Shumica e këtyre kulturave bujqësore janë të kultivuara në kopshtet e shtëpive dhe me kultivim ekstenziv, ndërsa vitet e fundit kanë filluar me kultivim intensiv.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024



Figuro 6 Pemët në tokë të punueshme sipas kulturës

Sipërfaqet e mbjellura me kultura me vlerë siç janë arra, lajthia, fruta manore, janë të vogla, kryesisht të mbjellura në oborre të shtëpive dhe shumë pak në pemihte intensive. Në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar ka rritje të kërkesës për arrë dhe lajthi. Aktualisht, në Kosovë deficitit tregtar në frutat arnore kap shifrën prej 1,3 Million Euro, kurse në tregjet evropiane deficitit shkon deri në 7 milion Euro. Prandaj, rritja e prodhimit intensiv të frutave arnore është vlerë e shtuar për sektorin e bujqësisë në Drenas, me një impakt të punësimit të lartë.

Sa i përket perimtarisë, në komunën e Drenasit prodhimtaria në secilën prej kulturave të perimeve ka shënuar rritje në vitet e fundit. Kulturat që më së shumti kultivohen në këtë veprimtari bujqësore janë: speci, domatja, trangujt dhe qepët. Këto katër kultura paraqesin rreth 70% të sipërfaqeve të mbjellura me perime. Sipas të dhënave nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2014, në Komunën e Drenasit janë më pak se 50ha, që mbillen me perime.




Figura 7 Pemët në tokë të punueshme sipas kulturës

Ngjashëm si tek sektori i pemtarisë, shumica e kulturave të perimeve kryesisht kultivohen në mënyrë ekstensive për nevojat familjare, ku numri i ekonomive bujqësore që kultivojnë këto kultura për çështje komerciale është i vogël. Sfidat më të shpeshta me të cilat ballafaqohen kultivuesit e këtyre kulturave bujqësore në komunën e Drenasit janë: fragmentimi i tokës, ndërtesat dhe pajisjet e vjetra,

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

mungesa e mjeteve financiare për investime, mungesa e masave mbrojtëse nga breshëri, mungesa e pikave për grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimeve, mungesa e rendimenteve si pasojë të pemishteve të vjetëruara, përmytjet e plantacioneve si pasojë e mungesës së sistemeve kulluese (drenazhimin), ndotja e lumenjëve, etj.

Në mënyrë që të adresohen sfidat e lartë përmendura rekomandohet që të realizohet vlerësimi i nevojave për trajnim të fermerëve, ku nëpërmjet këtij vlerësimi të bëhet identifikimi i nevojave reale të tyre dhe në bazë të të gjeturave të organizohen trajnime të rregullta me fermerë. Krijimi i pikave grumbulluese për ruajtjen e pemëve dhe perimeve është një masë tjetër tepër e nevojshme për fermerët e Drenasit përmes së cilave do të bëhej grumbullimi, klasifikimi, përpunimi dhe distribuimi i produkteve tek pikat e shitjes. Për më tepër, krijimi i depos për ruajtjen e prodhimeve bujqësore do të ishte një veprim tejjet me rëndësi për fermerët pasi që kjo do të mundësonte rritjen e vlerës dhe afatin e qëndrueshmërisë së produkteve, rrjedhimisht do t'ju zvogëlonte humbjet fermerëve. Jo më pak e rëndësishme është edhe promovimi i produkteve lokale bujqësore. Në këtë drejtim komuna do të përkushtohet për promovimin e produkteve përmes organizimit të panairëve ose mundësimin të prezantimit të produkteve të prodhuesve nga komuna e Drenasit, në panairët kombëtare dhe rajonale.

Sektori i Bletarisë

Një prej sektorëve më profitabil në fushën e bujqësisë është edhe bletaria. Komuna e Drenasit ka një pozitë të volitshme gjeografike për kultivimin e bletarisë. Aktualisht, në komunën e Drenasit llogaritet të jenë rreth 5000 koshere bletë.

Ky sektor është përkahur nga komuna në formën e rritjes së numrit të koshereve dhe bletarëve, por me gjithë përkrahjen nga komuna bletarët nuk kanë arritur të zhvillohen për sa i përket rritjes së numrit të produkteve të bletës, si psh.: propolisi, qumështi i bletës, poleni, etj. Bletarët janë të organizuar nëpërmjet Shoqatës së Bletarëve, ku herë pas here mbajnë trajnime dhe ligjerata për bletarët e rinjë, mbi kultivimin e bletëve. Megjithatë, edukimi i bletarëve edhe më tutje mbetet sfida e komunës dhe e Shoqatës së Bletarëve, sidomos në kontrollin dhe menaxhimin e sëmundjeve të bletëve. Regjistrimi i bletishteve, krijimi i pasaportës së bletës, lokalizimi i bletishteve, kultivimi i bimëve mjaltë-dhënëse dhe përpilimi dhe monitorimi i listës së sigurtë të barnave për bletët, mbetet edhe me tutje sfida për bletarët, Shoqatën e Bletarëve dhe komunën e Drenasit.

Përkushtimi i komunës duhet të fokusohet në avansimin e bletarisë në Drenas, nëpërmjet avansimit të bletarëve në aspektin profesional, zgjerimin e produkteve të bletës, dhe rritjen e kontrollit dhe menaxhimit të sëmundjeve të bletëve.

Sektori i Blegtorisë

Në komunën e Drenasit ekziston potencial i lartë për zhvillimin e blegtorisë, meqë kualiteti i tokës, kushtet klimatike, por edhe burimet e ujit janë mjaft të favorshme. Sipas të dhënave nga Regjistrimi i Bujqësisë i vitit 2014, Drenasi posedon rreth 6,692 ha me livadhe dhe kullota, të cilat paraqesin mundësi të mëdha për zhvillimin e blegtorisë. Për më tepër, si përparësi është që 86% të sipërfaqeve të kullotave janë kullota në tokë të përbashkët.




Figura 8 Kullotja e bagëtisë sipas pronsisë së kullotave

Rreth 4000 ekonomitë bujqësore mirren me rritjen e gjedheve, deleve si dhe dhive ndërsa prodhimi i mishit dhe bylmetit, janë produktet kryesore që prodhohen nga sektori i blegtorisë në komunën e Drenasit. Sa i përket ekonomive bujqësore që mbajnë gjedhe dhe lopë, 62% e tyre mbajnë nga 1-2 lopë, ndërsa 34% mbajnë 3-9 krerë lopë, gjë që nënkupton që shumica e ekonomive bujqësore në komunën e Drenasit merren me rritjen dhe mbajtjen e gjedheve për nevojat e konsumit familjar dhe shumë pak prej tyre i mbajnë për nevoja komerciale.




Figura 9 Madhësia e kopesë në ekonomitë bujqësore

Ngjashëm, është situata edhe në sektorin e shpezëtarisë, ku madhësia e tufës së shpendëve deri në 150 copë, përfaqësohet nga 68% e ekonomive bujqësore.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024




Figura 10 Madhësia e tufës së shpendëve në ekonominë bujqësore

Fermerët e gjedheve në komunën e Drenasit kanë nevojë për investime në stalla dhe objekte ndërtimore, investim në makineri të reja për prodhimin e ushqimit për kafshë në përputhje me standardet ekzistuese për mirëqenie të kafshëve dhe mjedisit. Gjithashtu, pajisje si: sistemi i furnizimit me ujë, sistemi i të ushqyerit, sistemi i largimit të plehut të stallës, makineritë e fermës për prodhimin, ruajtjen, përgaditjen, përdorimin dhe shpërndarjen e ushqimit janë të nevojshme për ngritjen e funksionalitetit në këtë sektor. Në komunën e Drenasit aktualisht nuk ka pikë grumbulluese të qumështit apo nënprodukteve të qumështit, prandaj është e rëndësishme të nxitet dhe ndihmohet krijimi i qendrës grumbulluese për prodhime blegtorale, ku blegtorët do të kenë mundësi që të bëjnë grumbullimin e qumështit apo nënprodukteve të qumështit.

Për më tepër, mbetet sfida që shumica e fermave nuk i përmbushin standardet për siguri dhe higjienë të ushqimit, për mirëmbajtje të kafshëve dhe mbrojtje të mjedisit. Përveç kësaj, Komuna duhet të angazhohet në rritjen e ndërgjegjësimit të fermerëve ndaj ndotjes së mjedisit, posaçërisht ndikimit që lëngu i plehut mund të ketë tek ujërat nëntokësore.

ARSIMI

Arsimi

Arsimi në Drenas përbëhet nga gjithsej cione arsimore, prej të cilave 1 shkollë e mesme e lartë, 1 shkollë e mesme profesionale, 30 shkolla fillore dhe 1 institucion Parashkollor.

Në institucionet edukativo-arsimore publike në Komunën e Drenasit punojnë p 1034 të punësuar, nga të cilët 849 janë mësime dhënë, 61 janë personel administrativ dhe 124 janë personel ndihmës. Në vitin shkollorë 2018/2019 nga 849 mësime dhënë 659 kanë qenë të angazhuar në nivelin parafillorë dhe të mesëm të ulët, 176 në arsimin e mesëm të lartë dhe 14 mësime dhënë në nivelin e arsimit parashkollorë.

Nga viti shkollorë 2015/2016 në vitin shkollorë 2019/2020 ka rënie të numrit të nxënësve për 8%, kurse rënia mesatare vjetore e numrit të nxënësve në Komunën e Drenasit është 3%.




Figura 11 Numri i përgjithshëm i nxënësve sipas viteve shkollore

Sa i përket raportit gjinor në vijimin e mësimit në nivelin fillorë dhe të mesëm, ekziston një ndarje proporcionale gjinore, megjithatë është vërejtur që në shkollat profesionale ka një dallim në mes të gjinive në vijimin e mësimit. Nga viti shkollorë 2015 e këndej numri i nxënësve meshkuj në shkollën profesionale është mbi 50% më i madh se numri i nxënësve të gjinisë femrore. Për këtë arsye, është shumë me rëndësi që të ketë një promovim më të madh të drejtimeve profesionale tek nxënëset e gjinisë femrore.

Raporti mësime dhënë-nxënës vazhdon të qëndrojë në kuotat mesatare në krahasim me mesatarën në Kosovë. 1/16.3 në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, 1/14.3 në nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët dhe 1/8.2 në nivelin e arsimit parashkollor.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024




Figura 12 Raporti nxënës/mësimdhënës sipas viteve shkollore

Kur jemi tek përgatitja akademike e stafit akademik në shkollat e Drenasit, nga grafiku i mëposhtëm mund të shihet qartë që 71% e mësimdhënësve kanë ngritje profesionale të nivelit Bachelor, 18% janë të nivelit Master, megjithatë në disa lëndë ku ka quadro deficitare, 5% e mësimdhënësve janë me shkollë të lartë dhe 6% me shkollë të mesme.




Figura 13 Personeli shkollor sipas përgatitjes akademike

Menaxhimi i arsimit dhe administratës

Të gjitha shkollat në komunën e Drenasit i kanë të themeluar këshillat drejtuese të shkollave, këshillat e prindërve, këshillat e nxënësve dhe aktivet. Për funksionimin e mirëfillt të këshillave dhe institucioneve tjera brenda shkollore, është shumë e nevojshme që të rritet efektshmëria, nëpërmjet fuqizimit të këtyre strukturave sidomos nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të tyre për rolin dhe funksionet e tyre. Kurse, sa i përket menaxherëve të shkollave, siç kërkohet me kornizën ligjore në fuqi, këta kanë përfunduar aftësimin profesional dhe trajnimet për pozitat udhëheqëse të cilat i ushtrojnë.

Si rrjedhojë e mungesës së kapaciteteve dhe aftësive për menaxhim financiar bazuar në rregullat në fuqi, por edhe të rrezikimit të qëndrueshmërisë financiare si pasojë e numrit të vogël të nxënësve në disa shkolla, kanë bërë që buxheti i shkollave të jetë ende nën menaxhimin e DKA-së.

DKA e Drenasit në vazhdimësi ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme për të garantuar aftësimin e menaxherëve të shkollave sipas nevojave reale të tyre, ndërsa deri sot nuk ka pasur ndonjë iniciativë për rritjen e bashkëpunimit mes shkollave në vend dhe jashtë, në mënyrë që mësimdhënësit dhe nxënësit e tyre të përfitojnë nga shkëmbimi i praktikave të suksesshme.

Aktualisht, nuk ka ndonjë praktikë të monitorimit të planeve të veprimit të shkollave, pasi që mungojnë kapacitetet profesionale të menaxherëve të shkollave për të kryer monitorimin. Andaj, rekomandohet që të organizohen trajnime për ngritjen e kapaciteteve të monitorimit, rrjedhimisht të krijohet sistemi i monitorimit për zbatimin e planeve të veprimit të shkollës. Për më tepër, duhet të standardizohen raportet e institucioneve brenda shkollave, por edhe raportet që përgatiten nga menaxhmenti i shkollave për DKA-në.

Sigurimi i Cilësisë

Korniza ligjore për arsimin fillor dhe të mesëm, por edhe dokumentet strategjike për sigurimin e cilësisë të hartuara nga MASHT, kanë rritur obligimet dhe përgjegjësitë e komunave në sigurimin e një sistemi cilësor të mësimdhënies. Në këtë drejtim, Komuna e Drenasit i ka caktuar koordinatorët e cilësisë, të cilët mbulojnë të gjitha shkollat e komunës. Koordinatorët e cilësisë raportojnë në mënyrë të rregulltë, por raportet e tyre nuk janë të standardizuara. Sa i përket nivelit të përgatitjes, koordinatorët e cilësisë kanë nevojë edhe më tutje për ngritjen e kapaciteteve të tyre, sidomos për rolin, përgjegjësitë dhe funksionin që ata duhet të kryejnë.

Gjithashtu, një sfidë tjetër për rritjen e cilësisë në arsim mbetet funksionalizimi i shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla. Aktualisht, shërbimi psikologjik nuk është funksional në asnjë shkollë, ndërsa deri më tani vetëm 7 pedagogë janë të angazhuar nga gjithsej 33 shkolla, disa mbulojnë më shumë se 1 shkollë. Për më shumë, si sfidë e theksuar e DKA-së mbetet monitorimi, vlerësimi, analizimi dhe raportimi standard dhe i mirëfilltë i performancës së mësimdhënësve, menaxhmentit të shkollës dhe zbatimit të kurrikulës. Për realizimin e një procesi standard të monitorimit dhe vlerësimit kërkohet ngritje e kapaciteteve profesionale të stafit në nivel komunal dhe shkollor.

Sa i përket aftësimin profesional, është shumë me rëndësi që nxënësit të cilët përfundojnë shkollimin profesional, të jenë sa më të gatshëm për tregun e punës. Andaj, në mënyrë që të bëhet ndërlidhja e aftësive me nevojat reale të tregut të punës, rekomandohet që DKA në bashkëpunim me DHZE dhe shkollën profesionale në mënyrë periodike të kryejnë analizën e nevojave të tregut. Në bazë të të gjeturave dhe konkluzioneve, duhet të rishikohen drejtimet ekzistuese dhe krijohen drejtime të reja të mësimin që përputhen me nevojat reale të tregut të punës.

Mjedisi Shkollor

Në komunën e Drenasit, 29 shkolla punojnë në dy ndërrime, ndërsa 4 punojnë vetëm në një ndërrim. Sa i përket numrit mesatar të nxënësve në klasë, ai varijon nga shkolla në shkollë, mirëpo mesatarja në nivel komunal është 20.1 nxënës për klasë. Ndër shkollat më të ngarkuara për nga numri i nxënësve në klasë janë shkolla "Naim Frashëri" në Gllobare dhe "Rasim Kijçina" në Drenas 2. Sa i përket gjendjes

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

infrastrukturore, në 20 objekte shkollore është vlerësuar të jetë e mirë, 9 objekte janë mesatare, ndërsa 3 objekte shkollore kanë gjendje të dobët infrastrukturore.




Figura 14 Gjendja e objekteve shkollore

Nga 33 institucione arsimore në Komunën e Drenasit, 1 objekt shkollos ka gjendje shumë të mirë të inventarit, 19 prej tyre kanë gjendje të mirë, 9 qëndrojnë mesatarisht, ndërsa 4 prej objekteve shkollore nevojë për përmirësim.





Figura 15 Gjendja e inventarit në shkollë

Me hyrjen në fuqi të kurrikulës, mjetet konkretizuese dhe pajisja e shkollave me laboratorë dhe kabinete është e domosdoshme. Në këtë kuptim, komuna e Drenasit ka inventarizuar një numër të shkollave, megjithatë duhet përmirësim në këtë fushë, sidomos në mirëmbajtje dhe në furnizimin e laboratorëve dhe kabineteve me material harxhues.



SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024

Tabela e paraqitur mëposhtë paraqet gjendjen ekzistuese të inventarizimit të kabineteve të shkollave, por edhe të hapësirave tjera të nevojshme për zhvillim të mësimi praktik. Për këtë arsye, Komuna e Drenasit duhet të përkushtohet më shumë në drejtim të përmirësimit dhe inventarizimit të shkollave me pajisje adekuate.

KABINETET/HAPËSIRAT PËR MËSIM PRAKTIK	NUK KA	PAJISJET JANË, OBJEKTI MUNGON	PAJISJET NUK JANË, OBJEKTI ËSHTË	PAJISJET DHE OBJEKTI JANË, POR NUK FUNKSIONOJNË	PAJISJET DHE OBJEKTI JANË, FUNKSIONOJNË
Bibliotekë	4	0	3	0	25
Informatikë	12	1	2	0	17
Fizikë	21	1	5	1	4
Kimi	21	1	4	0	6
Biologji	19	1	4	1	7
Fushë sportive	4	0	0	2	26
Sallë sportive	28	0	1	0	3

Figura 16 Kabinetet e punës / dhe labororet sipas disponueshmërisë dhe funksionalitetit në shkollë

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Sa i përket nivelit aktual të mësimitdhënësve, duhet të bëhet vlerësimi i nevojave për trajnim, për të kuptuar se cilat janë nevojat reale të tyre për trajnim.

Në vitet e fundit, Komuna e Drenasit në bashkëpunim me organizata të ndryshme, ka organizuar trajnime për zhvillim profesional të mësimitdhënësve. Për më tutje, është e rëndësishme që të zhvillohet vlerësimi i nevojave për trajnime për të gjithë mësimitdhënësit në komunën e Drenasit, bazuar në analizat dhe qasjet si në vijim: Analizën e Kompetencave; Analizën e Përmbajtjes; Analizën e Boshllëqeve; Vlerësimin e Nevojave; Analizën e Performancës; dhe Analizën e Deficitit të Performancës.

Bazuar në të gjeturat nga vlerësimi i nevojave për trajnim, DKA në koordinim me MASHT duhet të zhvillojë programin e trajnimit dhe t'a implementojë sipas të gjeturave të vlerësimit.

Në mungesë të mjeteve financiare për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, DKA duhet të krijojë instrumente brenda-shkollore përmes organizatave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, për të siguruar zhvillimin profesional të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm për mësimitdhënësit.

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Komuna e Drenasit ka rritur angazhimin dhe projektet për përmirësimin e sektorit shëndetësor dhe të mireqenies në Drenas. Përmirësimet janë bërë kryesisht në ndërtimin e institucioneve të reja të mjekësisë familjare, furnizimin me pajisje të reja dhe moderne mjekësore për Qendrat e Mjekësisë Familjare, furnizimi i rregullt me inventarë. Ngjashëm, është angazhuar edhe në fushën e Mirëqenies Sociale, veçmas në zgjidhjen e çështjes së banimit.

Sektori i shëndetësisë

Shërbimet e kujdesit primar shëndetësorë për qytetarët e komunës së Drenasit ofrohen përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, 5 Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe 17 Ambulantave Shëndetësore në pjesët rurale.

Në QKMF janë të punësuar gjithsej 182 punonjës prej të cilëve 42 janë mjekë/mjekë specialistë nga të cilët konsulentë specialistë janë gjithsej 12, 108 infermierë, mami, teknikë dhe laborantë, si dhe 32 staf administrativ.

Sa i përket gjendjes ekzistuese të objekteve shëndetësore në komunën e Drenasit, nga gjithsej 13 objekte shëndetësore, 6 objekte janë vlerësuar të kenë gjendje të mirë, 1 shkëlqyeshëm, 3 objekte me gjendje shumë të mirë, ndërsa 3 objektet e mbetura kanë nevojë për përmirësim.




Figura 17 Gjendja e objekteve shëndetësore

Nga gjithsej 13 objekte shëndetësore në komunën e Drenasit, 9 prej tyre posedojnë hapësirë të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, ndërsa 4 objekte kanë nevojë për zgjerim të hapësirës punuese, sidomos asaj laboratorike.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2024




Figura 18 Disponueshmëria e hapsirave të mjaftueshme në institucione shëndetësore sipas kornizës ligjore

Në 6 nga 13 objektet shëndetësore ekzistojnë pajisjet e nevojshme që parashihen me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa sa i përket gjendjes së pajisjeve ekzistuese, në 6 institucione shëndetësore të gjitha pajisjet funksionojnë, në 4 institucione funksionojnë pjesërisht, ndërsa në 3 institucione shëndetësore pajisjet funksionojnë, por janë të vjetëruara.




Figura 19 Disponueshmëria e pajisjeve medicinale të nevojshme sipas institucioneve shëndetësore




Figura 20 Numri i vizitave mjekësore në institucionet shëndetësore

Pavarësisht shtrirjes së madhe të rrjetit të Institucioneve shëndetësore, numri i vizitave në QKMF vazhdon të mbetet i lartë. Siç mund të shihet edhe në grafikonin e mëposhtëm, që nga vitit 2014 e këndej, me përjashtim të vitit 2015 dhe 2017, në QKMF janë realizuar mbi 130,000 vizita shëndetësore. Raporti i vizitave në mes të QKMF-së dhe AMF-ve është 1 me 50 kurse me QMF-të është 1 me 4. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që të bëhet informimi i vazhdueshëm i qytetarëve për shërbimet të cilat mund të ofrohen në QMF dhe AMF. Për më tepër, është e nevojshme rritja e numrit të shërbimeve shëndetësore në nivelin e QMF-ve dhe AMF-ve

Mirëqenia Sociale

Si rezultat i decentralizimit të shërbimeve sociale, komunat kanë marrë përgjegjësi më të mëdha në ofrimin e shërbimeve sociale. Sidoqoftë, komunat po ballafaqohen me sfida serioze në sigurimin e burimeve financiare për të ofruar shërbime cilësore sociale, pasi që ky decentralizim i shërbimeve nuk është shoqëruar me decentralizim financiar për ofrimin e këtyre shërbimeve.





Figura 21 Numri i përfutuesve sipas skemave pensionale dhe sociale

Në komunën e Drenasit janë gjithsej 8373 persona që përfitojnë nga skemat sociale dhe pensionale. Numrin më të lartë e përbëjnë pensionet bazike të moshës, skema e pensioneve të veteranëve të luftës dhe familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës. Gjatë vitit 2018 rreth 1123 familje kanë përfituar nga skemat e ndihmës sociale, kurse numri i anëtarëve të atyre familjeve është rreth 4992.

Në komunën e Drenasit, shërbimet sociale ofrohen nepërmjet Qendres për Punës Sociale (QPS) me gjithsej 11 zyrtarë të punësuar, nga të cilët 4 janë të angazhuar në ofrimin e shërbimeve sociale. Sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale, sfida mbetet mungesa e një hapësire për qëndrim ditore apo shtëpi të pleqëve, andaj ndërtimi dhe funksionalizimi i një qendre ditore apo shtëpie për pleqtë duhet të jetë një nga prioritetet e Komunës së Drenasit gjatë 5 viteve të ardhshme.



AMBIENTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Ambienti dhe shërbimet publike

Menaxhim i mbeturinave

